



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE	
Nr. _____	Prot. _____
Tiranë, më _____, 202	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 406/14 Prot.

Tiranë, më 04.04.2025

Lënda: Dërgim i raportit përfundimtar të auditimit

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
Tiranë

Nga data 27.01.2025 deri më 21.02.2025, Drejtoria e Auditimit, e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka zhvilluar një mision auditimi në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, me objekt: “Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në arritjen e objektivave”, për periudhën 01.02.2022 deri më 31.12.2024. Bashkëlidhur, ju dërgojmë “Raportin përfundimtar të auditimit”.

Në zbatim të procedurave ligjore për auditimin e brendshëm, ju kujtojmë se:

- Brenda 30 ditëve, nga marrja e “Raportit përfundimtar”, drejtuesi i Qendrës së Shërbimeve Arsimore duhet të miratojë “Plan-Veprimin” për zbatimin e rekomandimeve, sipas sugjerimeve të paraqitura në projekt raport, të cilin duhet ta dërgoni të nënshkruar në Drejtorinë e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Në se, institucioni i audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin e “Plan veprimit” dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, atëherë drejtuesi i NJAB-së informon Ministrin se drejtuesi dhe institucioni i audituar nuk kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, për të na ndihmuar që të vlerësojmë performancën e Drejtorisë së Auditimit dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë, duke plotësuar aneksin nr.2 “Reagim nga subjekti i audituar” bashkëlidhur, të cilin duhet të dërgoni në Drejtorinë e Auditimit.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi realizimin e angazhimit të auditimit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

I. Përmbledhje ekzekutive

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), është institucion shtetëror i krijuar në zbatim të VKM nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)", i ndryshuar me VKM nr.371, datë 26.4.2017, e cila ushtron veprimtarinë brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit dhe kryen funksionet:

- a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.
- b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.
- c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.
- ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.
- d) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.
- dh) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.
- e) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.
- ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.
- f) Publikon *on-line* programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.
- g) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.
- gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.
- h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj".

Objekti i veprimtarisë është ofrimi i shërbimeve për nxënësit, studentët, kandidatët për të marr titullin e një profesioni të rregulluar, shkollat, IAL-të, urdhrat profesionale, institucionet dhe të tretët dhe ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.



Drejtoria e Auditimit, auditori subjektin Qendra e Shërbimeve Arsimore, duke i kushtuar vëmendje objektivave kryesore të sistem/fushave, që lidhen me:

- vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në komponentët e tij;
- funksionimin e strukturës organizative, përputhshmëria me legjislacionin, si dhe objektivat e institucionit;
- krijimin dhe përdorimin e të ardhurave;
- zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen dhe dhënien e pagave;
- hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit;
- zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prokurimeve me fonde publike;
- sistemin e kontabilitetit financiar;
- sistemin e menaxhimit të aktiveve.

Objekti kryesor për çështjet e auditimit ka qenë, vlerësimi i plotë i veprimeve të marra nga menaxhimi i QSHA, në drejtim të elementëve të kontrollit, si edhe mbi të gjitha aktivitetet strategjike, funksionale apo operative, me qëllim shprehjen e opinionit mbi funksionimin e kontroleve, mbi mbajtjen në nivele të pranueshme të rrisqeve të identifikuara dhe kryerjen e veprimtarive, në funksion të arritjes së objektivave të planifikuara me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.

Misioni dhe qëllimi i auditimit: është vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazë risku, si dhe dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme nivelit të lartë të menaxhimit, me qëllim për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike (QSHA), duke ndihmuar për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të menaxhimit.

Periudha e audituar: Nga data 01.02.2022 deri më datën 31.12.2024.

Auditimi u krye: Nga 27.01.2025 deri më datë 21.02.2025.

Auditimi u realizua, sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e angazhimit të auditimit nr.406/1 prot., datë 22.01.2025.

Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve:

- Nga auditimi mbi vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, janë mbajtur parasysht elementet e tij, si: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi, por u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore që ndikojnë në krijimin e një mjedisi kontrolli jo efektiv, trajtuar sipas pikave të programit në këtë raport.
- Struktura organizative e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, funksionon me 29 punonjës, nga 44 të miratuar, e pa plotësuar për 15 pozicione pune.
- Lidhur me plotësimin e dosjeve të punonjësve me dokumentacion u konstatua parregullsi e karakterit të përputhshmërisë ligjore, pasi jo të gjitha dosjet ishin plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar në kreun II, pika 1, lidhja nr.1, të VKM nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbytjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
- Në sistemin e pagesave u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore, si vijon:
 - Për periudhën objekt auditimi u konstatua se për 2 punonjës, për llogaritja e shtesës për vjetërsi pune dhe pagesat ishin kryer më tepër se sa vitet faktike të dokumentuara në librezën e punës dhe regjistrin themeltar të punonjësve.
 - Nuk janë zbatuar procedurat dhe rregullat ligjore në fuqi në përllogaritjen dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat apo për kalimin e tyre në buxhetin e shtetit, si dhe nuk ishte bërë pagesa e shpërblimit për , bazuar në VKM nr.795, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në

kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian” dhe në urdhrin nr.16, datë 15.01.2024, të SP.

- Mangësi dhe mungesë transparence në dokumentimin dhe justifikimin e pagesave për honoraret e vlerësuesve të maturës shtetërore, Sesioni I, 2024".
- Në pagesat e kryera, për orët mbi kohën normale të punës është konstatuar mungesë e dokumentacionit në lidhje me mundësinë e kompensimit të orëve të punës me pushime (orë/ditë pushimi), mungesë e miratimit nga titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për orët në tërësi dhe për titullarin e QSHA, në veçanti, si dhe shpërndarje jo të drejtë e orëve në lidhje me angazhimin e punonjësve në organizimin e provimeve të maturës.
- Lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore, si vijon:
 - Mos ngritja e grupit të punës për hartimin e PBA-së dhe menaxhimin e programeve, mos dokumentimi e argumentimi i tyre për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve për çdo program, si dhe mos hartimi i raportit për kërkesat buxhetore sipas programeve apo i një relacioni të plotë për gjithë programin e QSHA, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.
 - Në kryerjen e pagesës për “Riparim pajisje printimi buklete”, nuk janë zbatuar procedurat ligjore dhe afatet e përcaktuara në kontratë, pasi kontrata është lidhur në qershor 2020, situacioni mbi kryerjen e shërbimeve është bërë në maj 2021, ndërsa fatura është lëshuar në mars 2022, duke krijuar dyshime për një dokumentim fiktiv të procesit dhe pasiguri në lidhje me ligjshmërinë e shpenzimeve.
 - QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit, për titullarin dhe punonjësit e saj, pa faturë tatimorë të fiskalizuar për biletat e udhëtimit/faturë hoteli dhe dieta për distanca më pak se 50 kilometra, jo në përputhje me përcaktimet në VKM -në nr.997, datë 10.12.2010, i ndryshuar.
 - QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit, pa dokumentacionin e duhur që justifikon shpenzimet dhe për vlera më të mëdha se kufijtë e lejueshëm të dietës/ditore.
 - QSHA, ka kryer shpenzime për transport, pa dokumentacionin e duhur që justifikon pagesat e bëra, duke krijuar dyshime për veprime dhe pagesa fiktive.
- Në fushën e prokurimit të fondeve publike, u konstatua parregullsi e karakterit të përputhshmërisë ligjore, si vijon:
 - Mungesa e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime.
 - Nuk ishte dokumentuar mënyra e përlllogaritjes së fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve e punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre.
 - Nuk ishin ngritur grupe pune për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura dhe për rrjedhojë nuk ishin mbajtur as proces verbalet, për marrjen në dorëzim të punëve, shërbimeve apo mallrave të furnizuara, lidhur me sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre, si dhe të dokumentacionit shoqërues.
 - Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave nuk kishin nënshkruar një deklaratë përmes së cilës të deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.
- Në fushën e kontabilitetit u konstatua parregullsi e karakterit të përputhshmërisë ligjore si vijon:
 - Mangësitë në procesin e inventarizimit të aktiveve kanë çuar në pasaktësi të pasqyrave financiare, mungesë transparence, vështirësi në përcaktimin e përgjegjësive dhe mosrespektim të standardeve ligjore, duke bërë që ato të jenë të pasakta dhe të pa-besueshme.
- Lidhur me menaxhimin e aktiveve u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore si vijon:
 - Nuk ishin hartuar dhe miratuar rregulla specifike dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.
 - Nuk është hartuar regjistri kontabël për aktivet që zotëron apo ka në administrim QSHA.



- Titullari i QSHA, nuk ka nxjerr rregullisht urdhrat për krijimin e komisioneve të inventarizimit. Nëpunësi zbatues nuk ka hartuar listën e plotë të aktiveve për inventarizim. Fletët e inventarit përmbajnë të dhëna vetëm për sasinë fizike, pa informacione kontabël, si dhe komisionet e inventarizimit nuk kanë dokumentuar procesin sipas kërkesave ligjore në fuqi.
- Mungesa e kontrollit dhe procedurave të qarta për të caktuar punonjësit për kryerjen e veprimeve me arkë dhe magazinë.
- Rregullorja e brendshme, është e vitit 2014 dhe e pa azhurnuar me zhvillimet e reja, për funksionimin normal të QSHA.
- Qendra e Shërbimeve Arsimore, ka angazhuar punonjës të jashtëm, si dhe ka kryer pagesa për shërbimet e ofruara prej tyre, pa lidhur kontratë pune për 3 raste.
- Mungesa e dokumentacionit dhe mosrespektimi i procedurave ligjore dhe financiare, në menaxhimin e kontratave dhe pagesave të kryera për konsulentët, ka krijuar risk për integritetin e projektit dhe mundësitë e auditimit.

Rekomandime për mangësi të konstatuara:

Rekomandim nr.1: QSHA, të kryejë procedurat për plotësimin e strukturës organike, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.1.1: Deri në plotësimin e vendeve vakante të punës QSHA, të rishikojë shpërndarjen e detyrave dhe ngarkesën e punonjësve aktualë, në mënyrë që të sigurojë realizimin e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësisë së saj.

Rekomandim nr.2: Njësia e burimeve njerëzore në QSHA, t'u kërkojë punonjësve që të paraqesin dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit dhe të bëjë, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar, referuar përcaktimeve të VKM-së nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Rekomandim nr.3: QSHA, përlllogaritjen e pagave ta bëjë sipas strukturës, vlerave të pagave, elementeve përbërës dhe kategorive përkatëse, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për pagat.


Rekomandim nr.3.1: QSHA, për periudhën e paguar më tepër dhe të bëjë përlllogaritjet e pagës që lidhen me shtesën e vjetërsisë në punë, referuar përcaktimeve ligjore përkatëse për pagat, si dhe për diferencat të bëhen ndalesat përkatëse.

Rekomandim nr.4: QSHA, për mos aplikimin e tatimit mbi pagesat, sipas përcaktimeve në aktet përkatëse ligjore në fuqi, të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësinë, të bëjë përlllogaritjet për tatimin mbi të ardhurat, për periudhën e audituar, për çdo rast e punonjës, si dhe për diferencat e konstatuara të pa mbajtura të bëhen ndalesat përkatëse dhe të xhirohen në buxhetin e shtetit.

Rekomandim nr.4.1: QSHA, të xhirojë menjëherë në buxhetin e shtetit shumën prej 622,465 lekë, që përfaqëson tatimin mbi të ardhurat për honorarët dhe komisionet, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e përcaktuara.

Rekomandim nr.4.2: QSHA, të verifikojë dokumentacionin dhe të bëjë pagesën e shpërblimit për , në përputhje me urdhrin e SP.

Rekomandim nr.5: QSHA, të krijojë një sistem të plotë dhe transparent dokumentimi për orët e punuara dhe numrin e testeve të vlerësuara, me tarifa të qarta dhe të miratuara dhe listëpagesat të përmbajnë informacion të plotë për treguesit që lidhen me pagesat, si dhe të kenë nënshkrimet e menaxherëve përkatës. Gjithashtu, të implementohet një sistem monitorimi, i cili garanton kryerjen pagesave në kohë, për të siguruar ligjshmërinë dhe transparencën e procesit.



Rekomandim nr.6: QSHA, të marrë masa për krijimin e procedurave, që përcaktojnë qartë mënyrën e dokumentimit dhe trajtimit të orëve mbi kohën normale të punës, për të siguruar që çdo orë pune e kryer jashtë kohës normale të punës, të jetë e dokumentuar, e justifikuar dhe të ketë mundësinë e kompensimit me pushime, përpara se të kërkohet miratimi i pagesës për këto orë, në mënyrë që të eliminohen shpenzimet e paautorizuara apo të paqarta dhe që janë jo në përputhje me rregullat përkatëse ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.6.1: Titullari i QSHA-së, të përdorë çdo mundësi për kompensimin e orëve mbi kohën normale të punës, me orë/ditë pushimi, dhe për rastet kur nuk është e mundur dhënia e pushimit, duhet të argumentohen, justifikohen dhe dokumentohen arsyet e kryerjes së pagesave, duke u siguruar që veprimet janë në përputhje me përcaktimet në VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Rekomandim nr.6.2: QSHA, për çdo orë të realizuar mbi kohën normale të punës përfshirë ato të titullarit dhe për të cilat ka përdorur të gjitha mundësitë për kompensimin e tyre, me orë/ditë pushimi, të kërkojë paraprakisht miratimin e pagesës së tyre nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mënyrë që të rrisë transparencën, kontrollin dhe përputhshmërinë me ligjin, duke parandaluar keqpërdorimet dhe shkeljet në të ardhmen.

Rekomandim nr.6.3: QSHA, planifikimin dhe shpërndarjen e orëve mbi kohën normale të punës, që realizohen në kuadër të organizimit të provimeve të maturës shtetërore, ta bëjë në përputhje me faktorë të tillë si përvoja, aftësitë dhe numri i personave që nevojiten për secilën detyrë, rolin dhe angazhimin e secilit individ në proces, bazuar në një plan të qartë dhe të miratuar paraprakisht nga titullari dhe struktura përgjegjëse, me qëllim shmangien e favorizimeve dhe të sigurojë trajtim të drejtë për të gjithë stafin.

Rekomandim nr.7: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në QSHA, në vijim urdhrit të titullarit të institucionit “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit”, me qëllim menaxhimin efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, me qëllim përcjelljen për në MAS të një informacioni sa më të plotë dhe të saktë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit.

Rekomandim nr.8: QSHA, të analizojë rastin, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.8.1: QSHA, të marrë masa për vendosjen e sistemeve të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shmangin çdo mundësi për keqpërdorim të fondeve apo krijojnë pasiguri ligjore, si dhe sigurojnë transparencën e procesit e llogaridhënien për çdo veprim të kryer.

Rekomandim nr.9: QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë qendrës së punës, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentojë me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë referuar përcaktimeve të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.

Rekomandim nr.9.1: QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit titullarit apo punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.

Rekomandim nr.10: QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë vendit, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentojë me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë referuar përcaktimeve të VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Rekomandim nr.10.1: QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përlllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të paguara më tepër, të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.

Rekomandim nr.11: QSHA, të analizojë rastin, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, si dhe të vendosë sisteme të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, shmangin çdo mundësi për keqpërdorim të fondeve, rrisin transparencën e llogaridhënien për çdo veprim të kryer, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.12: QSHA, të forcojë kapacitetet e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të krijojë dhe zbatojë procedura të qarta dhe të dokumentuara për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, duke siguruar që të mbahen dokumentet përkatëse që vërtetojnë këtë planifikim, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.13: Për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, që do të prokurohen nga njësia publike, në çdo rast të bëhet dokumentimi i mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.14: QSHA, në të gjitha rastet e prokurimit të fondeve publike, për kontratat e lidhura të ngrejë grupet për monitorimin e zbatimit të tyre, për t’u siguruar që të gjitha proceset e marrjes në dorëzim të punëve, shërbimeve dhe mallrave, të dokumentohen në mënyrë të rregullt dhe të mbahen procesverbalet përkatëse në praninë e kontraktorit, si dhe për të verifikuar përputhshmërinë e cilësisë, sasisë, llojit dhe plotësisë së punëve dhe furnizimeve, për të cilat është shpallur fitues kontraktori.

Rekomandim nr.15: Anëtarët e komisioneve që përfshihen në procesin e vlerësimit të ofertave, përpara hapjes së ofertave, të nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, për të siguruar transparencën dhe integritetin e procesit, duke parandaluar çdo mundësi për favorizim të ofertuesve dhe për të shmangur dyshimet për procedurën.

Rekomandim nr.16: Për hartimin e pasqyrave financiare të sakta dhe të besueshme, QSHA, të kryejë inventarizimin e plotë dhe të saktë të aktiveve, në mënyrë që të pasqyrojë gjendjen reale të tyre.

Rekomandim nr.16.1: Hartimi, përgatitja, paraqitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore, të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kontabël, në mënyrë që të sigurohet kontabilizimi i plotë, i saktë dhe në kohë i të gjitha transaksioneve, me qëllim që të japin gjendjen reale të pozicionit financiar dhe transaksioneve, si dhe informacion transparent e të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë.

Rekomandim nr.17: Titullari i QSHA, në mënyrë që të sigurojë menaxhim efikas të aktiveve dhe të parandalojë keqmenaxhimet e mundshme, të miratojë rregulla specifike dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.



Rekomandim nr.18: Të hartohet regjistri kontabël për të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim QSHA, si dhe të përditësohen në vazhdimësi të dhënat, me qëllim mirë menaxhimin e aktiveve, referuar përcaktimeve të Kreut III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafët 26-72, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandim nr.19: QSHA, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos kryerjen e inventarizimeve të aktiveve, si dhe të marrë masa të menjëhershme për të verifikuar ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës, nëpërmjet zbatimit të procedurave të inventarizimit.

Rekomandim nr.19.1: Nëpunësi zbatues të hartojë listën e plotë të aktiveve për inventarizim, e cila të përditësohet rregullisht dhe të përfshijë të dhëna të plota dhe të sakta për çdo aktiv.

Rekomandim nr.19.2: Komisionet e inventarizimit duhet përdorin fletë inventari që përmbajnë të dhëna kontabël, në mënyrë që të kenë mundësinë e krahasimit me të dhënat nga verifikimi fizik për secilin aktiv, si dhe të dokumentojnë plotësisht procesin e inventarizimit, referuar përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar

Rekomandim nr.20: Drejtori i QSHA, me urdhër të veçantë të ngarkojë një punonjës të institucionit, për kryerjen e veprimeve me arkë dhe një punonjës tjetër për kryerjen e veprimeve me magazinën, në zbatim të paragrafit 15, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandim nr.20.1: QSHA, të krijojë dhe miratojë një procedurë të detajuar për lëvizjen e materialeve nga magazina, duke përfshirë një plan shpërndarjeje të miratuar nga titullari, për të parandaluar gabimet.

Rekomandim nr.20.2: Nëpunësi zbatues të bëjë verifikimin e rregullt të gjendjes së arkës dhe materialeve në magazinë, për të garantuar saktësinë e regjistrimeve dhe për të identifikuar çdo mospërputhje ose gabim në kohë

Rekomandim nr.21: QSHA të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për rishikimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e QSHA”, që ajo të mbulojë nevojat e ndryshuara për menaxhimin e sistemeve të kontrollit dhe proceseve operative, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar të institucionit.

Rekomandim nr.22: QSHA, në çdo rast të angazhimit të punonjësve të jashtëm të bëjë lidhjen e kontratave të rregullta të punës, në përputhje me ligjin e punës dhe procedurat administrative të institucionit, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen ligjore të të dy palëve dhe do të shmangë rrisqet e mundshme.

Rekomandim nr.22.1: QSHA, pagesat t’i kryejë vetëm pasi të jenë lidhur kontratat përkatëse për punonjësit e jashtëm, për të siguruar që çdo pagesë të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe do të parandalojë mundësinë e keqpërdorimit të fondeve.

Rekomandim nr.22.2: QSHA, të marrë masa për krijimin dhe vendosjen e një sistemi të qartë kontrolli për pagesat e punonjësve të jashtëm, që përfshin lidhjen e kontratave dhe dokumentimin e plotë të shërbimeve të ofruara prej tyre.

Rekomandim nr.23: Të krijohet dhe implementohet një procedurë e qartë për dorëzimin dhe pranimin e produkteve, e cila të sigurojë që çdo produkt regjistrohet në dokumente dhe miratohet zyrtarisht nga QSHA dhe konsulentët, si dhe ruhet në mënyrë të detajuar si pjesë e arkivës të projektit.

Rekomandim nr.23.1: Në përmbushje të kushteve të kontratës, QSHA të kërkojë detyrimisht paraqitjen e faturave nga konsulentët pas përfundimit të shërbimit, si dhe të sigurohet që çdo

faturë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale, përpara se të realizohen pagesat, nëpërmjet vendosjes së një sistemi monitorimi dhe kontrolli për verifikimin e faturave të paraqitura, në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me shërbimet e kryera, duke ndihmuar në ruajtjen e transparencës dhe përputhshmërinë me marrëveshjet.

Rekomandim nr.23.2: Të dokumentojë përlllogaritjen e shumave për çdo pagesë që bëhet, duke siguruar që çdo pagesë të bazohet në një përlllogaritje të qartë, transparente dhe e cila të përfshijë kriteret dhe arsyetimin për llogaritjen, në mënyrë që vendosë një sistemi kontrolli, që të verifikojë se çdo pagesë të bëhet në përputhje me kontratën dhe shërbimin e kryer, si dhe parandalon keqpërdorimet me fondet.

Rekomandim nr.23.3: Të zbatohen detyrimisht procedurat ligjore në fuqi, duke dokumentuar qartë përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim, për çdo pagesë të bërë për konsulentët, me qëllim për të shmangur pasaktësitë dhe ndëshkimet ligjore.

Rekomandim nr.24: QSHA, të analizojë situatën në tërësi, të identifikojë përgjegjësitë për çdo mangësi të konstatuar dhe të ndërmarrë masa urgjente për të adresuar shkeljet në përputhshmërinë ligjore dhe procedurat financiare. Kjo përfshin përmirësimin e menaxhimit të burimeve, dokumentacionit dhe kontrollit të pagesave, si dhe forcimin e monitorimit dhe transparencës në proceset e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Gjithashtu, është e domosdoshme përditësimi i rregulloreve të brendshme për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe efikas, që plotëson plotësisht kërkesat ligjore dhe financiare.

Opinion mbi veprimtarinë e QSHA, është se në sistemet e kontrollit sipas sistem/fushave të audituara për periudhën objekt auditimi janë konstatuar veprime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi, trajtuar në raport. Mbështetur në germën 'e', të nenit 16, të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Kapitulli IV, pikat 4.1.11 dhe pika 4.1.12, për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të QSHA, si dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes së veprimeve që nuk janë në përputhje me aktet ligjore, kemi lënë rekomandimet përkatëse.

II. Hyrje

Misioni i auditimit, në Qendrën e Shërbimit Arsimor, u zhvillua mbështetur në Ligjin nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" të ndryshuar, në planin vjetor të auditimit, të miratuar nga Ministri me shkresën nr.6067/1 prot., datë 18.10.2024, si dhe në zbatim të programit të angazhimit të auditimit nr.406/1 prot., datë 22.01.2025.

Me datë 27.01.2025, në QSHA, u zhvillua takimi i hapur për prezantimin e grupit të auditimit dhe të objektivave të misionit me drejtuesit e entitetit të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i QSHA, znj.Aida Myrto, Drejtor i Drejtorisë së vlerësimit znj. Bora Habili, Përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore znj.Egli Peçi, Përgjegjës i sektorit të administrimit të provimeve të shtetit znj.Sonila Bushi, Përgjegjës i sektorit të njohjes së diplomave z.Olsi Vangjeli dhe Përgjegjës i sektorit të regjistrimit të studentëve znj.Teuta Braçaj.

Auditimi u krye për periudhën nga data 01.02.2022 deri me 31.12.2024, sipas drejtimeve në programin përfundimtar, pas dakortësimit me përfaqësuesit e QSHA, në takimin e hapur. Gjatë auditimit u shqyrtua me zgjedhje dhe në tërësi sipas rastit, çështjeve dhe nivelit të riskut, dokumentacioni i kërkuar i vënë në dispozicion nga QSHA.

Baza ligjore:

- Ligji nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;
- Manuali i auditimit të brendshëm, i ndryshuar;



- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10 296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr.560, datë 29.09.2018, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, ndryshuar;
- VKM nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e agjencisë kombëtare të provimeve, i ndryshuar”;
- VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, i ndryshuar;
- VKM nr.120, datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”;
- VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar;
- VKM nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”;
- Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”;
- Si dhe çdo akt tjetër ligjor që lidhet me veprimtarinë e institucionit.

Arsyet për auditim janë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut, si dhe dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme nivelit të lartë të menaxhimit nëse sistemet e kontrollit për periudhën objekt auditimi kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në njësinë e audituar.

Misioni i Auditimit u realizua nga grupi i auditit i Drejtorisë së Auditit në MAS i përbërë nga Isa Neza dhe Ilirjana Çina, në zbatim të programit të angazhimit të auditimit nr.406/1 prot., datë 22.01.2025.


Auditimi u krye nga data 27.01.2025 deri me datë 21.02.2025.

III. Metodatat e auditimit të përdorura gjatë kryerjes së auditimit, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat kanë si qëllim marrjen e informacionit të detajuar dhe të mjaftueshëm nga personat e autorizuar, janë:

a. *“intervistimi”*, duke përdorur teknikat e pyetësorëve për kontrollet e brendshme të cilat janë përgatitur paraprakisht, si edhe analizimi i dokumentacionit.

b. *“Testimi hap pas hapi”*, që përfaqëson ndjekjen brenda sistemit të transaksioneve specifike nga fillimi deri në fund, për të parë se si njësi publike i përmbahet procedurave të caktuara.

c. *Testimi i detajuar*, që përfshin ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, e cila na jep evidenca më të besueshme se sa intervistimi dhe e përdorim pasi kemi planifikuar që të marrin të dhëna nga të gjithë transaksionet (ose nga një shembull për transaksionet në një grupim.



Teknikat e auditimit të përdorura janë:

- i. *Sondazhet*, që duhet të përfshijnë jo më pak se 25 % të transaksioneve për fushën përkatëse me qëllim që zgjedhja të jetë përfaqësuese dhe përftohet një bindje e arsyeshme për vërtetësinë e operacioneve të audituara.
- ii. *Përzgjedhja me gjykim*, që kërkon një vlerësim profesional, është më efiçente dhe ekonomike e përdoret ku madhësia e përzgjedhjeve është e vogël ose aty ku nuk pritet që rastësia të na japë përzgjedhje që mund të përfaqësojnë masën, tërësinë e proceseve a transaksioneve.

Në përfundim të angazhimit të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, testeve, pyetësorëve dhe shqyrtimit të shpjegimeve të personave të subjektit të audituar, u përgatitet projekt-raporti i auditimit, i cili me shkresën nr.406/3, datë 19.03.2025, i është dërguar QSHA, në të cilin janë sugjeruar rekomandimet, për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në të ardhmen.

Duke qenë se Qendra e Shërbimeve Arsimore, nuk është përgjigjur me shkrim lidhur me projekt raportin dhe rekomandimet e lëna, si dhe nuk ka kërkuar takim ballafaques, grupi i auditimit i konsideron të pranueshme të gjitha rekomandimet dhe mbështetur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësi e audituar", dërgon raportin përfundimtar të auditimit dhe pret nga subjekti i audituar plan veprimin e plotësuar nga ana e tij.

IV. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për çdo sistem, sipas drejtimeve të auditimit të miratuara në program.

1. Auditim mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në komponentët e tij:

Vlerësimi i efektivitetit të kontrollit të brendshëm kryhet në drejtim të hartimit të kontrolleve të brendshme, implementimit dhe funksionimit të tyre, për të cilat Njësitë publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve si vijon:

A. Mjedis i kontrollit;

Në auditimin dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, janë mbajtur parasysh elementet e tij, si vijon:

- a. integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë.
- b. politikat menaxheriale dhe stili i punës;
- c. struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- d. politikat dhe praktikët e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- e. aftësitë profesionale të punonjësve.

Qendra e Shërbimeve Arsimore, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores së Brendshme protokolluar me nr.1462 prot., datë 02.09.2014 dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore " i ndryshuar.

Lidhur me respektimin e etikës, QSHA, i është referuar rregullave dhe parimeve të përcaktuara në Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Për periudhën e audituar QSHA, ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës së

miratuar me Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018, i ndryshuar, sipas së cilës rezultoi e organizuar me 1 drejtor të përgjithshëm, 3 drejtori dhe 1 sektor, me 44 punonjës të miratuar në total. Për ndarjen e detyrave janë bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e QSHA, si dhe në përshkrimet e punës, por është konstatuar se jo në çdo rast ka pasur një ndarje të qartë dhe në përputhje me procedurat e rregullat e vendosura për këtë qëllim.

Marrëdhëniet e punës për drejtorin dhe punonjësit e QSHA dhe procedurat e rekrutimit të stafit rregullohen sipas përcaktimeve në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Menaxhimi i burimeve njerëzore lidhur me punësimin, lidhjen e kontratave të punës, lëvizjet e punonjësve, administrimin e dosjeve të personelit etj., kryhen nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Aftësitë profesionale dhe performanca e punonjësve është kryer nëpërmjet vlerësimit të tyre nga eprorët direkt, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, të cilat ishin depozituar në dosjet personale. Nga kryerja e auditimit u konstatuan mangësi që ndikojnë në krijimin e një mjedisi kontrolli jo efektiv, si në rastin e mungesës së dokumentacionit në lidhje me mundësinë e kompensimit të orëve të punës të realizuara mbi kohën normale, me pushime (orë/ditë pushimi); mos marrjes së miratimit tek titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sporti, për orët mbi kohën normale të punës që rezultojnë të realizuara nga titullari i QSHA, për të cilat është paguar, çfarë tregon dobësi në krijimin dhe zbatimin e një mjedisi kontrolli efektiv, duke bërë të nevojshme marrjen e masave për forcimin e politikave, procedurave dhe për vendosjen e rregullave të qarta për menaxhimin e orëve mbi kohën normale të punës dhe të angazhimeve të punonjësve jashtë orari të zakonshëm. Kjo do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe integritetit në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore. Po ashtu edhe në rastin e mungesës së dokumentacionit dhe mosrespektimit të procedurave ligjore dhe financiare, në menaxhimin e kontratave dhe pagesave të kryera për konsulentët, në kuadër të projektit për zbatimin e Konventës së Njohjes së Lisbonës – mbështetje për Qendrat ENIC, apo në raste të tjera të trajtuara në këtë raport, çfarë tregon dobësi në krijimin e një kulture kontrolli brenda QSHA-së, ku të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e menaxhimit të fondeve të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e dokumentimit dhe përmbushjes së kushteve të kontratave.

Referuar, sa më sipër dhe për raste të tjera, trajtuar sipas pikave të programit në këtë raport rezultoi se gjatë realizimit të detyrës, jo në çdo rast është mbajtur një qëndrim mbështetës kundrejt kontrollit të brendshëm.

B. Menaxhimi i riskut;


Menaxhimi i riskut është i rëndësishëm për QSHA, për të identifikuar, vlerësuar dhe për të vendosur kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që mund të sjellin efekte të dëmshme në arritjen e objektivave.

Për të mundësuar dhe influencuar ofrimin e shërbimeve, janë vendosur procedura kontrolli nga menaxhimi i njësisë publike nëpërmjet miratimit të rregullave, të cilat duhet të ruhen dhe përditësohen rregullisht dhe të vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar rrisqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Nga auditimi u konstatua se sistemet e kontrollit lidhur me menaxhimin e riskut nuk kanë funksionuar në rastin e:

- Kompensimit të orëve mbi kohën normale të punës, shpërndarjes së tyre midis punonjësve që angazhohen në procesin e organizimit të provimeve të maturës shtetërore, si dhe të mos marrjes



së miratimit në MAS, pasi mungon dokumentacioni përkatës. QSHA, duhet të identifikojë dhe adresojë rrisqet që lidhen, duke krijuar mekanizma për minimizimin e tyre;

- Mungesës së dokumentacionit dhe mosrespektimit të procedurave ligjore dhe financiare, në menaxhimin e kontratave dhe pagesave të kryera për konsulentët, në kuadër të projektit për zbatimin e Konventës së Njohjes së Lisbonës - mbështetje për Qendrat ENIC, për të cilat QSHA, duhet të kishte zhvilluar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrisqeve të mundshme, duke përfshirë procedura për monitorimin e shpenzimeve dhe dokumentimin e saktë të pagesave, në mënyrë që mundësonte ndërmarrjen e masave për parandalimin e tyre;
- Angazhimit të punonjësve të jashtëm, si dhe të kryerjes së pagesave për shërbimet e ofruara prej tyre, pa lidhur kontratë pune;
- Kryerjes së pagesave për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, për shërbime transporti etj, jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Kryerjes së procedurave të prokurimit dhe marrjes në dorëzim të materialeve apo shërbimeve, jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Administrimit të aktiveve apo të hartimit të pasqyrave financiare, jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Përllogaritjes së shtesës së pagës për vjetërsinë në punë etj.

Sa më sipër, dhe për raste të tjera janë konstatuar parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore, të cilat janë trajtuar sipas pikave të programit në këtë raport dhe për të cilat auditit shprehet se sistemet e kontrollit të brendshëm në këto fusha kanë vepruar jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

C. Aktivitetet e kontrollit;


Nga auditimi i ushtruar lidhur me aktivitetet e kontrollit rezultoi se Njësia publike nuk kishte të miratuar një manual për procese kryesore operationale dhe financiare, në të cilin të jenë përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që rrisqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut, por i është referuar akteve/nënakteve ligjore në fuqi sipas fushave përkatëse të veprimtarisë dhe transaksioneve financiare të realizuara, ku nga auditimi kanë rezultuar mangësi të theksuara, të cilat janë trajtuar sipas pikave në raport.

Qarkullimi dhe ruajtja e dokumentacionit kryhej nga sektorët në bashkëpunim me zyrën e protokollit, referuar rregullave në fuqi.

Lidhur me përmbajtjen e aktiviteteve të kontrollit, institucioni i është referuar përcaktimeve në pikën 3, të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, por jo në çdo rast aktivitetet kanë funksionuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Jo në të gjitha rastet likuidimet financiare nënshkruheshin nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, pasi nga verifikimi dokumenteve u konstatua se për periudhën 2022-2024, kanë qarkulluar 5 nëpunës zbatues, të emëruar në detyrë me urdhrat: nr.139, datë 10.10.2023, nr.148, datë 24.10.2023, nr.13, datë 24.01.2024, nr.67, datë 25.04.2024, ndërsa me urdhrin nr.136, datë 03.10.2023, është liruar nga detyra nëpunësi i mëparshëm. Gjatë këtyre periudhave është konstatuar se megjithëse janë emëruar në detyrë nëpunësit zbatues sipas urdhrave të lartpërmendur, urdhër shpenzimet nënshkruheshin jo nga nëpunësi zbatues i caktuar, por nga një tjetër punonjës që ka qenë i emëruar si nëpunës zbatues, në periudha të mëparshme. Ndryshimi kaq i shpeshtë i nëpunësve zbatues është një risk shumë i lartë për QSHA dhe është jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe me Urdhrin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore" i ndryshuar.

Për transaksionet që ishin kryer me arkë dhe magazinën u konstatua se, nuk funksiononin sistemet e kontrollit të brendshëm, pasi në strukturën dhe organikën e miratuar nuk ishte parashikuar pozicioni për arkëtar dhe magazinier, si dhe nuk kishte urdhër të titullarit për caktimin e



punonjësve për këto dy pozicione pune, duke krijuar rrisht në kryerjen e transaksioneve, për shkak të mos identifikimit të rrisht dhe mungesës së kontrolleve të duhura.

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve si dhe mos zbulimin e tyre, titullari duhet të kishte vendosur rregulla që e shpërndajnë përgjegjësinë e kryerjes së veprimeve tek punonjësit të ndryshëm (në rastin konkret tek arkëtari dhe magazinieri). Për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni, përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Referuar problematikave të konstatuara rezulton se veprimtaritë e kontrollit kanë qenë të pamjaftueshme, si në rastin e shpërndarjes jo të drejtë të orëve mbi kohën normale të punës, për punonjësit e angazhuar në procesin e provimeve të maturës shtetore, si dhe në mungesën e miratimeve për këto angazhime shtesë. Për këtë nuk ka patur mekanizma të qartë, që lidhen me verifikimin dhe miratimin e orëve shtesë, çka ka krijuar apo krijon mundësi për keqpërdorim. Duhet që QSHA, të përmirësojë procedurat për miratimin dhe regjistrimin e çdo angazhimi të punonjësve jashtë orarit normal të punës, të pagesave të kryera për konsulentët, në kuadër të projektit për zbatimin e Konventës së Njohjes së Lisbonës – mbështetje për Qendrat ENIC, për të cilat QSHA, nuk vendosur kontrolle financiare dhe administrative në çdo fazë të zbatimit të projektit, pasi nuk kishte bërë verifikimin paraprak lidhur me zbatimin e kushteve të vendosura në kontratat e lidhura, përpara se të bënte pagesat etj.


Sa më sipër, rezulton se nuk kanë funksionuar kontrollet parandaluese ose para faktit, i cili është i konceptuar për parandalimin e dështimeve, paafësive, gabimeve dhe dobësive dhe gjejnë zbatim në kohën e zhvillimit të një aktiviteti ose gjatë kryerjes së detyrave të punonjësve, si dhe janë më të favorshme nga kontrollet e tjera, në aspektin e kostove të tyre, pasi ato parandalojnë humbjet dhe kufizojnë rrisht të caktuara. Gjithashtu nuk kanë funksionuar as kontrollet pas faktit në rastin e pagesave të bëra jo në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe procedurat e mbikëqyrjes e monitorimit, të cilat duhet të kryhen çdo ditë nga menaxherët e të gjitha niveleve të njësisë publike, me qëllim përmbushjen e detyrave të caktuara nga punonjësit dhe arritjen e objektivave të njësisë. QSHA, duhet të miratojë procedurat e ushtrimit të kontrolleve para faktit, që lidhen me veprimtaritë kryesore të institucionit, në përputhje me udhëzimet e ministrisë së financave.

D. Informimi dhe komunikimi.

Informimi dhe komunikimi është një proces thelbësor që lidhet me shkëmbimin e informacioneve ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, horizontalisht/vertikalisht dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet, për të koordinuar aktivitetet, për arritjen e objektivave.

Nga auditimi rezulton se në QSHA, ka patur një mungesë të informacionit dhe komunikimit të qartë mes niveleve të ndryshme të menaxhimit dhe punonjësve, lidhur me politikat dhe procedurat që duhen ndjekur për menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarive të kryera nga strukturat e QSHA, kjo referuar rrishtve dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuara sipas pikave të programit në këtë raport. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit nuk kanë funksionuar siç duhet horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Menaxherët e njësisë nuk kanë zotëruar informacion të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrave dhe marrjen e përgjegjësisë për menaxhimin financiar dhe të kontrollit, kjo pasi janë konstatuar shumë mangësi, që janë trajtuar në raport.

Sa më sipër, referuar mangësive të konstatuara dhe trajtuara në raport rezulton se sistemi aktual i informimit dhe komunikimit ka qenë i pamjaftueshëm për zbatimin e detyrave dhe ka nevojë për përmirësim.



E. Monitorimi i kontrollit të brendshëm.

Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe komponentët e tij të veçantë vlerësohen nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm ose nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme. Gabimet, parregullsitë dhe defektet e identifikuara në veprimtaritë apo transaksionet e kryera nga menaxherët dhe punonjësit e institucionit janë një burim shumë i mirë të dhënash mbi cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Monitorimi i kontrollit të brendshëm duhet të garantojë se të gjitha problemet e identifikuara, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk ka funksionuar, pasi nuk ka patur monitorim të vazhdueshëm të veprimtarive të kryera, vetëvlerësim të kryer nga vetë punonjësit, përgjegjësit e sektorëve apo Titullari i QSHA, kjo referuar mangësive të konstatuara dhe të trajtuara në këtë raport.


Sa më sipër, duhet të krijohet një sistem më i fortë monitorimi për të siguruar që politikat dhe procedurat e miratuara për veprimtaritë që kryen QSHA, të zbatohet siç duhet. Monitorimi i rregullt duhet për të identifikuar dhe adresuar në kohë çdo mangësi ose shkelje të mundshme, në mënyrë që të mund parandalojë shkeljet dhe të sigurojë përputhshmërinë me politikat dhe ligjet e përkatëse në fuqi.

2. Auditim i sistemit mbi funksionimin e strukturës organizative, përputhshmëria me legjislacionin dhe objektivat institucionit. Struktura dhe organigrama e miratuar, përputhshmëria e kriterëve profesionale me kërkesat e vendit të punës, trajnimi i stafit për pozicionet e punës, përshkrimi i pozicioneve të punës, vlerësimi i performancës së punonjësve dhe plotësimi i dosjeve të punonjësve me dokumentacion.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me funksionimin e strukturës rezulton se për periudhën objekt auditimi ky subjekt ka funksionuar si Qendra e Shërbimeve Arsimore, e organizuar në zbatim të VKM nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)", i ndryshuar me VKM nr.371, datë 26.4.2017, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore " i ndryshuar. Organika e QSHA rezulton me 1 drejtor të përgjithshëm, 3 drejtorë dhe 1 sektor, me 44 punonjës të miratuar në total.

Struktura organike e miratuar dhe plotësimi i saj në fakt paraqitet në tabelën që vijon:

Nr.	Pozicioni	Numri		Pa plotësuar
		Miratuar	Fakti	
1	Drejtor i Përgjithshëm.	1	1	0
1.1	Sekretar	1	1	0
2	Drejtorja e vlerësimit.	14	9	5
	Drejtor;	1	1	0
2.1	Sektori i provimeve dhe vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare;	8	4	4
	Përgjegjës Sektori;			
	Specialist.	1	1	0
	Sektori i administrimit të provimeve;	7	3	4
2.2	Përgjegjës Sektori;	5	4	1
	Specialist.	1	1	0
		4	3	1
3	Drejtorja e provimeve të shtetit.	7	4	4
	Drejtor;	1	0	1
3.1	Sektori i administrimit të provimeve të shtetit;	3	1	2
	Përgjegjës Sektori;	1	0	1
	Specialist.	2	2	2
3.2	Sektori i menaxhimit të fondit të pyetjeve;	3	3	0



	Përgjegjës Sektori; Specialist.	1 2	1 2	0 0
4	Drejtorja e shërbimeve arsimore.	17	12	5
4.1	Drejtor; Sektori i regjistrimit të studentëve; Përgjegjës Sektori; Specialist.	1 4 1 3	0 0 1 3	1 0 0 0
4.2	Sektori i regjistrimit të nxënësve në AP; Përgjegjës Sektori; Specialist.	4 1 3	2 1 1	2 0 2
4.3	Sektori i njohjes së diplomave të AP dhe legalizimeve; Përgjegjës Sektori; Specialist.	4 1 3	2 1 1	2 0 2
4.4	Sektori i njohjes së diplomave të AL, i pajisjes së IAL, me regjistra dhe i regjistrimit të formave të diplomave; Përgjegjës Sektori; Specialist.	4 1 3 4	4 1 1 4	0 0 2 0
5	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; Përgjegjës Sektori; Specialist (finance) Specialist (Jurist) Specialist Arkiv/Protokoll.	4 1 1 1 1	3 1 1 0 1	1 0 0 1 0
	TOTALI	44	29	15

Sipas të dhënave në tabelë rezulton se organika e QSHA, është miratuar me 44 punonjës në total dhe në fakt funksionon me 29 punonjës, e pa plotësuar për 15 punonjës, jo në përputhje me strukturën organike të miratuar.


Referuar organikës së miratuar vendet vakante të paplotësuara rezultonin në pozicionet e punës si më poshtë vijon:

NR	Pozicioni i punës	Numri i vendeve i pa plotësuar	Struktura që i përket
1	Drejtor	2	Drejtorja e provimeve të shtetit Drejtorja e shërbimeve arsimore
2	Përgjegjës Sektori	1	Sektori i administrimit të provimeve të shtetit, në Drejtorinë e provimeve të shtetit.
3	Specialist	12	Sektori i provimeve dhe vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare (4); Sektori i administrimit të provimeve (1) Sektori i administrimit të provimeve të shtetit (2); Sektori i regjistrimit të nxënësve në AP (2); Sektori i njohjes së diplomave të AP dhe legalizimeve (2); Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore (1)

Sa më sipër konstatohet se ka një diferencë të madhe mes numrit të punonjësve të miratuar dhe atyre aktualisht të angazhuar dhe kjo situatë paraqet rrisht, pasi ka ndikim në përmbushjen e objektivave të QSHA dhe veçanërisht për strukturat përkatëse që u përkasin. Gjithashtu ky rrisht bën që të ketë mungesë koordinimi të punëve për kryerjen e shërbimeve, shpërndarje të paefektshme të detyrave dhe ngarkesë të tepërt për punonjësit ekzistues, gjë që ndikon në cilësinë e shërbimeve dhe arritjen e objektivave të organizatës.

Titulli i gjetjes: Struktura organizative e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, funksionon me 29 punonjës, nga 44 të miratuar, e pa plotësuar për 15 pozicione pune.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.



Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)”, i ndryshuar me VKM nr.371, datë 26.4.2017; Urdhri i Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore ” i ndryshuar. Rregullore e brendshme për funksionimin e QSHA, protokolluar me nr.1462 prot., datë 02.09.2014.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Struktura organizative e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, funksionon me 29 punonjës, nga 44 të miratuar, e pa plotësuar për 15 pozicione pune. Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore ” i ndryshuar . Ndikimi/Efekti: Kjo situatë çon në ulje të efikasitetit të punës, vonesa në realizimin e detyrave dhe mbingarkesë të stafit ekzistues, duke rrezikuar përmbushjen e objektivave të QSHA. Shkaku: Mungesa e kontroleve që lidhen me zhvillimin e procedurave ligjore, për plotësimin e strukturës.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Struktura organike të miratuar është e paplotësuar për 15 pozicion pune, për të cilin duhet zhvillohen procedurat për plotësimin e tij, referuar përcaktimeve ligjore.
Rekomandimi	-QSHA, të kryejë procedurat për plotësimin e strukturës organike, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi. -Deri në plotësimin e vendeve vakante të punës QSHA, të rishikojë shpërndarjen e detyrave dhe ngarkesën e punonjësve aktualë, në mënyrë që të sigurojë realizimin e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Referuar, udhëzimit të ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, si dhe kreut IV “Rregullat për marrëdhëniet e punës”, të rregullores së brendshme për funksionimin e QSHA, protokolluar me nr.1462 prot., datë 02.09.2014, marrëdhëniet e punës rregullohen sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.

Nga auditimi rezulton se rekrutimi i punonjësve në strukturat e QSHA është bërë, sipas procedurave të Kodit të Punës dhe rregullores, në përfundim të procedurave drejtori me urdhër të veçantë ka bërë emërimin në detyrë për çdo të punësuar, me të cilët janë lidhur kontratat e punës. Lidhur me trajnimin e stafit të QSHA, për pozicionet e punës që ata kryejnë rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ishte kryer ndonjë trajnim, pasi në dosjet e verifikuara nuk kishte ndonjë dokument që lidhet me trajnimet.

Vlerësimi i performancës së punonjësve është bërë çdo vit dhe çdo vlerësim u gjet në dosjen personale të stafit. Lidhur me plotësimin e dosjeve të punonjësve me dokumentacion rezultoi se QSHA, kishte organizuar arkivën e dosjeve personale të punonjësve, ku ishin të depozituara të


gjitha dosjet e punonjësve. Organizimi i arkivës së dosjeve personale të punonjësve ishte bërë bazuar në VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” nga data 01.11.2020 e në vazhdim.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve, u konstatuan mangësi në plotësimin e dosjeve me dokumentacion në 3 raste, ku mungonin dokumente si: *Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, Feta e inventarit, Raporti mjeko-ligjor (Nuk ishte rifreskuar çdo vit); çertifikata familjare*. Mos plotësimi i dosjeve me dokumentacion është jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhja nr.1, të VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Titulli i gjetjes: Dosjet e punonjësve, jo në të gjitha rastet ishin plotësuar me dokumentacion, sipas përcaktimeve në lidhjen nr.1, të VKM nr.833, datë 28.10.2020.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në 3 raste dosjet e punonjësve, nuk ishin plotësuar me dokumentacion, sipas përcaktimeve në lidhjen nr.1, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020. Kriteri: Mos plotësimi i dosjeve me dokumentacion, është jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhja nr.1, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020. Ndikimi/Efekti: Mos respektim i procedurave ligjore pa ndikim financiar; Shkak: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët
Konkluzioni	Ndikimi ka qenë mos respektim i procedurave ligjore lidhur me plotësimin e dosjeve të punonjësve me dokumentacion. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve të identifikuara, eliminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	Njësia e burimeve njerëzore në QSHA, tu kërkojë punonjësve që të paraqesin dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit dhe të bëjë, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar, referuar përcaktimeve të VKM-së nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit vlerësojmë se sistemet e kontrollit lidhur me plotësimin me dokumentacion të dosjeve të punonjësve, nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.



4. Auditim mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, financimi nga buxheti i shtetit, aplikimi i tarifave për shërbimet e ofruara, të ardhurat e arkëtuara nga veprimtaria e saj dhe përdorimi i të ardhurave.

Nga verifikimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezultoi se QSHA, ka si burime financimi fondet nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj, për shërbimet e ofruara. Për periudhën objekt auditimi krijimi i të ardhurave është nga arkëtimi i tarifave të caktuara për shërbimet e ofruara nga QSHA, referuar përcaktimeve në VKM nr.560, datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, i ndryshuar. Për shërbimet që ofron QSHA, për të cilat nuk aplikohet tarifë shërbimi sipas vendimit të sipërcituar, financohen nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Referuar përcaktimeve në pikën 4, të VKM nr.560, datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore” i ndryshuar, QSHA, ka të drejtën e përdorimit të 90 për qind e të ardhurave nga veprimtaria e saj, të cilat autorizohen dhe përdoren në programin buxhetor 09450, kapitulli 06, “Të ardhura të veta jashtë limitit”.

Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përdoren për:

- a) Mbulimin e shpenzimeve të personelit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në shpenzime personeli përfshihen pagat e punonjësve, si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore;
- b) Mbulimin e shpenzimeve të veprimtarisë së Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ku përfshihen dhe mbulimi i shpenzimeve të hartimit, vlerësimit e korigjimit të testeve të provimeve, si dhe pagesa e kuotave/tarifave në rrjetet ndërkombëtare;
- c) Mbulimin e shpenzimeve për investime në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të QSHA-së

Të ardhurat e pa përdorura gjatë vitit financiar kalojnë në vitin pasardhës, sipas përcaktimeve në pikën 7, të VKM nr.560, datë 29.09.2018. Tarifat për shërbimet e ofruara, janë sipas Aneksit 1, që i bashkëlidhet VKM nr.560, datë 29.09.2018, i ndryshuar.

Të gjitha të ardhurat e krijuara dhe përdorimi i tyre është bërë nëpërmjet degës së thesarit, por nga verifikimi i dokumenteve të pagesave për periudhën objekt auditimi janë konstatuar raste të përdorimit të fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe pa ekonomikitet.

Sa më sipër, auditimi i jep siguri të arsyeshme menaxhimit se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

5. Auditimi i sistemit të pagave dhe përputhshmëria me legjislacionin. Dokumentimi i prezencës në punë të punonjësve (listë prezencë), hartimi i listë-pagesave e llogaritja e pagave, shtesave mbi to, pagesat për honorarë të ndryshme etj., llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe xhirimi i tyre në buxhetin e shtetit, si dhe llogaritja e dhënias dhe shpërblimeve.

Nga auditimi me zgjedhje lidhur me sistemin e pagave, zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës e të pagave, llogaritjen e tyre, sistemi i listë-pagesave, sigurimet shoqërore e shëndetësore, rezultoi se prezenca në punë dhe koha e punës së punonjësve evidentohet, me listë-prezencë, e cila nënshkruhet rregullisht. Për llogaritja e pagesave në listë-pagesat e punonjësve, ishte bërë mbi bazën e listë-prezencave në punë të punonjësve, të hartuar nga çdo strukturë dhe të miratuara nga Titullari i QSHA, si dhe sipas pozicionit, kategorisë së pagës, shtesës për vjetërsi, shtesave për kualifikim (për rastet kur ka), shtesës së pozicionit, të përcaktuar në VKM nr.187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit,

institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar kjo deri me datë 01 Prill 2023. Për çdo punonjës është e evidentuar vjetërsia në pune dhe bazuar në këto të dhëna janë përlllogaritur pagesat për vjetërsi në pune 2% për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet, kjo deri me datë 1 Prill 2023.

Ndërsa për periudhën nga 1 Prilli e në vazhdim ishin bërë referuar VKM nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Liste pagesat plotësoheshin nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (liste-prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse), si dhe kontrolloheshin dhe nënshkruheshin nga punonjësi i caktuar, nëpunësi zbatues dhe Titullari i QSHA, referuar përcaktimeve në paragrafin 69, të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Përmbledhësja e listë pagesave, e cila shoqëron urdhrin për shpenzimin e pagave, nënshkruhej nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi Autorizues, referuar përcaktimeve në paragrafin 70, të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Për rastet e dhënies së lejeve vjetore administroheshin në çdo rast urdhrat dhe autorizimet e titullarit.

Nga auditimi lidhur me përlllogaritjen e pagesave për vjetërsi në pune të punonjësve të QSHA, u konstatua mangësi, pasi për 2 punonjës () nuk përputheshin vitet e punës mbi të cilat është përlllogaritur pagesa për vjetërsi, me vitet e punës të dokumentuara në librezën e punës dhe regjistrin themeltar të punonjësve. Përlllogaritja dhe dhënia e pagesave me tepër janë jo në përputhje me vlerën e shtesës së pagës për vjetërsi pune, të përcaktuar në pikën 1, germa ‘ç’, ku citohet: “*Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:*

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit, si dhe jo në përputhje me përcaktimet e pikës 3, ku citohet: “Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “*vite pune*” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, **me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie**”, të kreut II, “Kategoritë, klasat dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore”, të VKM nr.325, datë 31.5.2023, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se për 2 punonjës, përlllogaritja e shtesës për vjetërsi pune dhe pagesat ishin kryer më tepër se sa vitet faktike të dokumentuara në librezën e punës dhe regjistrin themeltar të punonjësve.

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	VKM nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Përshkrimi i gjetjes	Situata: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se për 2 punonjës, përllogaritja e shtesës për vjetërsi pune dhe pagesat ishin kryer më tepër se sa vitet faktike të dokumentuara në librezën e punës dhe regjistrin themeltar të punonjësve. Kriteri: Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, germa ‘ç’ dhe të pikës 3, të kreut II, “Kategoritë, klasat dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore”, të VKM nr.325, datë 31.5.2023, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore në përllogaritjen dhe kryerjen pagesave për shtesën e vjetërsisë në punë, me efekt ekonomik, në vlerën e pagesës së kryer më tepër. Shkaku: Mungesa e kontroleve dhe procedurave që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Mos respektimi i përcaktimeve ligjore, lidhur me përllogaritjen dhe kryerjen pagesave për shtesën e vjetërsisë në punë, për 2 raste. Marrja e masave dhe vendosja e kontroleve, ndaj rrisqeve të identifikuara, eliminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	-QSHA, përllogaritjen e pagave ta bëjë sipas strukturës, vlerave të pagave, elementeve përbërës dhe kategorive përkatëse, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për pagat. -QSHA, për periudhën e paguar më tepër dhe , të bëjë përllogaritjet e pagës që lidhen me shtesën e vjetërsisë në punë, referuar përcaktimeve ligjore përkatëse për pagat, si dhe për diferencat të bëhen ndalesat përkatëse.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore që paguhen nga punëdhënësi dhe atyre që paguhen nga punëmarrësi janë përllogaritur ndaluar dhe kaluar në favor të buxhetit të shtetit, në përputhje me Ligjin nr.7703 datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, VKM nr.1114 datë 30.07.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr.7703 datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar.

Tatimi mbi të ardhurat personale të punonjësve është përllogaritur, ndaluar nga paga e punonjësve dhe kaluar në favor të buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar deri më 31.12.2023 dhe nga 1 Janari 2024, e në vazhdim sipas përcaktimeve të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, *por rezultoi se* me U. Shpenzimet nr.444 dhe nr.445, datë 10.01.2024, ishte dhënë shpërblim për punonjësit, bazuar në VKM nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, si dhe në urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm (SP) të MAS nr.16, datë 15.01.2024 “Për shpërblimin e punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në procesin e shqyrtimit analitik të të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, ndërsa me U. Shpenzimin nr.463, datë 23.01.2024, ishin paguar honorarë, për një punonjës, në vijim të projektit për zbatimin e Konventës së Njohjes së Lisbonës - mbështetje për Qendrat ENIC, për të cilin ishte lidhur marrëveshja grantit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023, e cila kishte si objekt financimin e pagesave për shpenzimet që duhen përballuar për zbatimin e projektit, për të cilat *u konstatua se* nuk ishte mbajtur tatimi mbi të ardhurat, sipas kërkesave të ligjit, si dhe

të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’ ku citohet: “Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të taten duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës”. Në urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS nr.16 datë 15.01.2024, në pikën 2/b/c, janë përcaktuar 4 punonjës të QSHA, që përfitojnë shpërblimin, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, por nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se ishin paguar vetëm 2 punonjës, një nuk ishte paguar se ishte larguar nga QSHA dhe nuk përmbushte kriteret e përfitimit, sipas kërkesave të pikës 4 të VKM nr.795, datë 28.12.2023, ndërsa për punonjësin , i përfshirë në këtë listë, me numër rendor 5, pika 2/c, nuk i është bërë pagesa e shpërblimit, për të cilin nuk kishte asnjë shpjegim apo argumentim, duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet në VKM dhe urdhrin e SP.

Po ashtu me U. Shpenzimet nr.36, datë 05.03.2024 dhe nr.42, datë 04.03.2024, janë kryer pagesa për honorarë, për komisione, për të cilat ishte llogaritur tatimi mbi të ardhurat por nuk ishte xhiruar në buxhetin e shtetit, për shumën 622 465 lekë, duke vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara.

Titulli i gjetjes: Nuk janë zbatuar procedurat dhe rregullat ligjore në fuqi për:

- përllogaritjen dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat, në rastin e pagimit të shpërblimeve dhe honorarëve të dhëna për punonjësit, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian.
- nuk ishte xhiruar në buxhetin e shtetit shuma 622 465 lekë, që përfaqëson tatim të mbajtur mbi të ardhurat për pagesat e kryera, për honorarë komisionesh;
- nuk ishte bërë pagesa e shpërblimit për , referuar përcaktimeve në urdhrin e SP.

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të MAS nr.16, datë 15.01.2024 “Për shpërblimin e punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në procesin e shqyrtimit analitik të të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nuk janë zbatuar procedurat dhe rregullat ligjore në fuqi për: - përllogaritjen dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat, në rastin e pagimit të shpërblimeve dhe honorarëve të dhëna për punonjësit, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, pasi nuk janë tatuar sipas kërkesave të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’, ku citohet: “Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të taten duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës”; - nuk ishte xhiruar në buxhetin e shtetit shuma 622 465 lekë, që përfaqëson tatim të mbajtur mbi të ardhurat për pagesat e kryera, për honorarë komisionesh, pasi nuk është bërë deklarimi në sistemin tatimor dhe plotësuar dokumentacioni I pagesës;



Nga verifikimi i dokumenteve të pagesave rezultoi se me U. Shpenzimet nr.373, datë 03.12.2024, ishte paguar shuma 933 617 lekë dhe nr.399, datë 20.12.2024, paguar shuma 429 403 lekë, për honorarë për vlerësues lëndë me zgjedhje, të maturës shtetërore sesioni I, 2024, por përse i përket dokumentacionit që lidhet me realizimin e procesit apo justifikimin e pagesave u konstatuan mangësi si vijon;

- Nuk janë të dokumentuara orët e punuara apo numri i testeve të vlerësuara nga secili vlerësues;
- nuk ka evidence apo një dokument, lidhur me vlerën e tarifave, që aplikohen në rastin kur pagesa bëhet mbi bazën e testeve të vlerësuara, si ka dalë kjo vlerë, sa teste duhet të vlerësojë një vlerësues për një orë, ku është e dokumentuar apo kush e ka miratuar atë tarifë etj;
- listëpagesa nuk është e plotë dhe qartë, pasi nuk përmban të dhëna lidhur orët e punuara, tarifën për orë, mbi bazën e të cilave duhet të përlogaritet pagesa;
- nuk ka dokumente me nënshkrime të rregullta nga menaxherët përkatës për secilin rast;
- mungon dokumentacioni për mënyrën e llogaritjes së shumave të paguara;
- nuk ka një dokument që lidhet me monitorimin dhe transparencën e procesit;
- nuk ka vijueshmëri në kryerjen e pagesave, pasi për sezonin e I Qershor-Korrik), pagesa është kryer në Dhjetor, trajtuar mësipër, pas 6 muajsh, pavarësisht se ka pasur fonde të mjaftueshme

Sa më sipër, mangësitë dhe problematikat e konstatuara në dokumentimin dhe justifikimin e pagesave, ndikojnë në transparencën dhe ligjshmërinë e procesit të pagesave dhe krijojnë risk lidhur me mundësinë e kryerjes së pagesave të pajustificuara ligjërisht, çka mund të çojë në keqpërdorim apo shpërdorim të fondeve publike. Mungesa e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt gjithashtu rrit mundësinë e gabimeve në përlogaritjen e pagesave dhe ndikon në besueshmërinë e procesit. Veprimet janë jo në përputhje me përcaktimet në nenin 4/26, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku citohet: *"Dokument financiar" është çdo dokument origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik".*

Titulli i gjetjes: Mangësi dhe mungesë transparence në dokumentimin dhe justifikimin e pagesave për honoraret e vlerësuesve të maturës shtetërore, Sesioni I, 2024".

Nr. i Gjetjes 5	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në kryerjen e pagesave për honorarë për vlerësues lëndë me zgjedhje, të maturës shtetërore sesioni I, 2024, kishte mangësi dhe mungesë transparence në dokumentimin dhe justifikimin e pagesave. Kriteri: Kryerja e pagesave, nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të përcaktuara në nenin 4/26, të tij. Ndikimi/Efekti: Ndikimi i këtyre mangësive është se ato pengojnë kontrollin e saktë të procesit dhe krijojnë mundësi për keqpërdorim dhe mosrespektim të ligjit dhe procedurave të parashikuara. Po ashtu krijojnë mungesë transparence dhe besimi në proceset e pagesave dhe e bën të vështirë monitorimin dhe ndjekjen e pagesave.

	Shkak: Mos zbatim i kërkesave ligjore dhe rregullave të përcaktuara për dokumentimin dhe justifikimin e pagesave.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Nga verifikimi i dokumenteve të pagesave për honorarët e vlerësuesve të maturës shtetërore, sesioni I, 2024, rezulton se ka mangësi të konsiderueshme në dokumentimin dhe justifikimin e pagesave, të cilat ndikojnë në besueshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij procesi. Mungesa e dokumenteve të nevojshme, të cilat duhet të pasqyrojnë saktë orët e punuara, numrin e testeve të vlerësuara dhe tarifat përkatëse, krijon mundësi për keqpërdorim dhe shkelje të procedurave të parashikuara. Po ashtu, vonesat në realizimin e pagesave, pavarësisht fondeve të mjaftueshme, reflektojnë mangësi në menaxhimin dhe transparencën e procesit. Këto mangësi kërkojnë masa të menjëhershme për të siguruar dokumentimin dhe procedurat e nevojshme, për të garantuar korrektësinë, transparencën dhe ligjshmërinë e pagesave në të ardhmen.
Rekomandimi	QSHA, të krijojë një sistem të plotë dhe transparent dokumentimi për orët e punuara dhe numrin e testeve të vlerësuara, me tarifa të qarta dhe të miratuara dhe listëpagesat të përmbajnë informacion të plotë për treguesit që lidhen me pagesat, si dhe të kenë nënshkrimet e menaxherëve përkatës. Gjithashtu, të implementohet një sistem monitorimi, i cili garanton kryerjen pagesave në kohë, për të siguruar ligjshmërinë dhe transparencën e procesit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Sa më sipër, auditit shprehet se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë nuk kanë vepruar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumenteve të pagesave rezultoi se me U. Shpenzimet nr.245, datë 02.09.2024 dhe nr.275, datë 02.10.2024 etj., ishin kryer pagesa për orë pune jashtë kohës normale, për organizimin e provimeve të maturës shtetërore, për vitin 2024. Pagesat i përkasin sezonit I, që përfshin periudhën Qershor-Korrik dhe sezonit II, që përfshin periudhën Gusht-Shtator. Referuar kërkesave të kreut II “Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë”, të VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, titullari i institucionit duhet tu kishte ofruar punonjësve që kanë realizuar orë punë shtesë kompensimin me orë/ditë pushim, ku për këtë në pikën 12, të këtij kreu citohet: **“Titullari i institucionit detyrohet t’i japë të punësuarit pushimin, sipas përcaktimeve në pikat 8 dhe 9, të këtij kreu, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë”**. Rezulton se Qendra e Shërbimeve Arsimore, me shkresën nr.1242 prot., datë 23.04.2018, ka kërkuar në ministrinë e financave miratim mbi pagesën e orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të saj, për punonjës të angazhohen në procesin e realizimit të maturës shtetërore 2018. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.8084/1, datë 23.05.2018, me lëndë ‘Mbi mbikohën e punës’, drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe për dijeni Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është shprehur se ka miratuar si veprimtari operacionale, veprimtarinë e punonjësve që angazhohen në procesin e realizimit të maturës shtetërore, për shkak të specifikave të saj. Për rrjedhojë, meqenëse kjo veprimtari përsëritet çdo vit, ajo **mbetet veprimtari operacionale, me qëllim pagesën e orëve të mbikohës së punës, në rast se kjo mbikohë nuk mund**

të kompensohet me orë/ditë pushimi dhe nuk është e nevojshme të kërkohet miratimi çdo vit buxhetor.

Referuar konstatimeve të mësipërme rezultuan mangësi që lidhen me:

- a. Mungesën e dokumentacionit në lidhje me mundësinë e kompensimit të orëve të punës me pushime (orë/ditë pushimi), gjë e cila ka krijuar apo mund të krijojë risk lidhur me :
 - Kryerjen e pagesave të paautorizuara ose të pasigurta, duke cënuar transparencën dhe ligjshmërinë e procesit financiar.
 - Krijimin e dyshimeve lidhur me përdorimin e fondeve dhe mundësinë e keqpërdorimit të tyre;
 - Krijon mundësinë për mosmarrëveshje midis palëve të përfshira dhe mund të dëmtojë besimin në procesin administrativ.

Sugjerime për përmirësime nga QSHA:

- për orët e punës shtesë të realizuara nga punonjësit, duhet që titullari i QSHA, të përdorë çdo mundësi për kompensimin me orë/ditë pushimi, në përputhje me kërkesat e VKM nr.568, datë 06.10.2021, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
 - të krijojë një procedurë të qartë dhe të dokumentuar, për të siguruar që çdo orë pune e kryer jashtë kohës normale të punës, të jetë e justifikuar dhe të ketë mundësinë e kompensimit me pushime, përpara se të kërkohet miratimi i pagesës për këto orë.
 - para se të kërkohet miratimi i pagesës, duhet të sigurohet që të gjitha dokumentet e nevojshme për kompensimin e orëve të punës mbi kohën normale, janë të plota dhe në përputhje me rregullat përkatëse ligjore në fuqi.
- b. Titullari i QSHA, për orët mbi kohën normale të punës, për të cilat është paguar, nuk ka marrë miratim nga titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, gjë e cila ka krijuar apo mund të krijojë risk lidhur me :
 - Kryerjen e pagesave që nuk janë të justifikuara ligjërisht, duke shkaktuar pasiguri dhe rrisqe për institucionin që mund të përballlet me ankesa ose kërkesa për rikthimin e fondeve, si dhe mund të sjellë pasoja ligjore për të dyja palët (QSHA dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit);
 - krijimin një situatë të pasigurisë dhe të paqartësisë për menaxhimin e financave publike, duke sjellë përdorim të parregullt të fondeve publike apo jashtë destinacionit të miratuar;
 - pasaktësi në raportimet financiare të institucionit dhe ndikim në besueshmërinë e raportimit të financave të QSHA.
 - marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet QSHA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pasi mund të shkaktojë tensione të mundshme që mund të ndikojnë në funksionimin e institucioneve.

Sugjerime për përmirësime nga QSHA:

- të kërkohet miratimi nga titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për çdo orë mbi kohën normale të punës dhe pas marrjes së miratimit të procedohet me pagesat, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara.
- të rishikohen dhe përmirësohen procedurat administrative brenda QSHA-së, për të siguruar që çdo veprim që ka të bëjë me orët mbi kohën normale të punës dhe pagesat e tyre, të kalojë nëpërmjet miratimeve të duhura.
- organizimi i trajnimeve për stafin e QSHA-së dhe drejtorët e njësive të saj, për tu siguruar që ata janë të njohur me rregulloret dhe procedurat e aplikueshme në lidhje me orët shtesë të punës dhe pagesat përkatëse, me qëllim parandalimin e shkeljeve të mundshme në të ardhmen.
- të rishikohet mënyra e planifikimit të orëve shtesë të punës, duke u siguruar që çdo orë shtesë të justifikohet dhe të jetë në përputhje me nevojat reale të punës, me qëllim eliminimin e shpenzimeve të paautorizuara dhe të paqarta.

- Sugjerime për përmirësime nga QSHA:*

- Sa më sipër, u konstatua se ka mungesë dokumentacioni për mundësinë e kompensimit të orëve të punës me orë/ditë pushimi dhe nuk ka miratim nga titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për orët e paguara për titullarin e QSHA-së. Gjithashtu, ka shpërndarje të padrejtë të orëve në lidhje me angazhimin e punonjësve në organizimin e provimeve të maturës, të cilat ndikojnë në përputhshmërinë me politikën, procedurat dhe rregullat ligjore.

Nr. i Gjetjes 6	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në pagesat e kryera, për orët mbi kohën normale të punës është konstatuar mungesë e dokumentacionit në lidhje me mundësinë e kompensimit të orëve të punës me pushime (orë/ditë pushimi), mungesë e miratimit nga titullari i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për orët në tërësi dhe për titullarin e QSHA, në veçanti dhe shpërndarje jo të drejtë e orëve në lidhje me angazhimin e punonjësve në organizimin e provimeve të maturës.

	Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e kreut II “Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë”, të VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën. Shkaku: Mungesa e kontroleve dhe procedurave që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Në lidhje pagesat për orët mbi kohën normale të punës të kryera, janë konstatuar disa mangësi në dokumentacion, përfshirë mungesën e miratimit nga titullarët e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, mungesën e miratimeve për kompensimin e orëve/ditëve me pushime, si dhe shpërndarjen jo të drejtë të orëve midis punonjësve të përfshirë procesin e provimeve të maturës. Për të shmangur këto rrisqe dhe pasojat ligjore, është e nevojshme që angazhimi i punonjësve të jashtëm të bëhet vetëm pas lidhjes së kontratave të rregullta pune, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin e punës dhe duke mbrojtur të drejtat e punonjësve dhe interesat e institucionit.
Rekomandimi	- QSHA, të marrë masa për krijimin e procedurave, që përcaktojnë qartë mënyrën e dokumentimit dhe trajtimit të orëve mbi kohën normale të punës, për të siguruar që çdo orë pune e kryer jashtë kohës normale të punës, të jetë e dokumentuar, e justifikuar dhe të ketë mundësinë e kompensimit me pushime, përpara se të kërkohej miratimi i pagesës për këto orë, në mënyrë që të eliminohen shpenzimet e paautorizuara apo të paqarta dhe që janë jo në përputhje me rregullat përkatëse ligjore në fuqi; - Titullari i QSHA-së, të përdorë çdo mundësi për kompensimin e orëve mbi kohën normale të punës, me orë/ditë pushimi, dhe për rastet kur nuk është e mundur dhënia e pushimit, duhet të argumentohen, justifikohen dhe dokumentohen arsyet e kryerjes së pagesave, duke u siguruar që veprimet janë në përputhje me përcaktimet në VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; - QSHA, për çdo orë të realizuar mbi kohën normale të punës përfshirë ato të titullarit dhe për të cilat ka përdorur të gjitha mundësitë për kompensimin e tyre, me orë/ditë pushimi, të kërkojë paraprakisht miratimin e pagesës së tyre nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mënyrë që të rrisë transparencën, kontrollin dhe përputhshmërinë me ligjin, duke parandaluar keqpërdorimet dhe shkeljet në të ardhmen. - QSHA, planifikimin dhe shpërndarjen e orëve mbi kohën normale të punës, që realizohen në kuadër të organizimit të provimeve të maturës shtetërore, ta bëjë në përputhje me faktorë të tillë si përvoja, aftësitë dhe numri i personave që nevojiten për secilën detyrë, rolin dhe angazhimin e secilit individ në proces, bazuar në një plan të qartë dhe të miratuar paraprakisht nga titullari dhe struktura përgjegjëse, me qëllim shmangien e favorizimeve dhe do të sigurojë trajtim të drejtë për të gjithë stafin.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.



6. *Auditimi i sistemit të buxhetit dhe përputhshmëria me legjislacionin. Hartimi e zbatimi i buxhetit, përdorimi i fondeve sipas destinacionit të përcaktuar dhe rakordimet periodike e vjetore me degën e thesarit për shpenzimet e kryera.*

Buxheti i QSHA, përbëhet nga financimi i fondeve nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj, si dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj, për shërbimet e ofruara. Lidhur me hartimin e buxhetit, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar propozimet e projekt buxhetit të ndërsjella nëpërmjet strukturave (sektorëve) të institucionit, deri në miratimin final të PBA-së, me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit të këtij procesi.


Rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk është ngritur grupi i punës për hartimin e PBA-së dhe menaxhimin e programeve, sipas viteve përkatëse, për rrjedhojë nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e drejtuesit, si dhe të anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit, referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe pika 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”.

Gjithashtu projekt buxhetet e hartuara për periudhën objekt auditimi, nuk janë të argumentuara me dokumente për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve sipas programeve, pasi mungojnë analizat përkatëse sipas zërave, si dhe nuk kanë raporte të hartuara për kërkesat buxhetore sipas programeve apo një relacion të plotë për gjithë programin e QSHA, referuar përcaktimeve të pikës 8 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Për hartimin e projekt buxheti, në nenin 12 “Përgjegjësi i Sektorit të Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse”, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e QSHA”, e miratuar me vendimin e BA, nr.72, datë 10.09.2022, është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet strukturave të institucionit.

Titulli i gjetjes: Mos ngritja e grupit të punës për hartimin e PBA-së dhe menaxhimin e programeve, mos dokumentimi e argumentimi i tyre për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve për çdo program, si dhe mos hartimi i raportit për kërkesat buxhetore sipas programeve apo i një relacioni të plotë për gjithë programin e QSHA, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Nr. i Gjetjes 7	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”. Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e QSHA”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Për periudhën objekt auditimi nuk është ngritur grupi i punës për hartimin e PBA-së dhe menaxhimin e programeve, sipas viteve përkatëse, për rrjedhojë nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e drejtuesit, si dhe të anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit, referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe pika 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”.



a.Me u. shpenzimin nr.60, datë 23.03.2023, ishte kryer pagesa subjektit “Kallfa” sh.p.k, për faturën nr.529, datë 21.03.2022, në shumën 895 320 lekë, lloji i procesit “*Faturim i dërgesave të mallrave dhe shërbimeve kundrejt porositjeve të blerjes*”, me objekt shpenzimi “Riparim pajisje printimi buklete”.

Dokumentet bashkëlidhur, urdhër shpenzimit për këtë pagesë janë sa vijon:

- Urdhër prokurimi nr.37, datë 11.05.2020, protokolluar me nr.1539;
- formulari i njoftimit të kontratës (duhet të ofertës), portokolluar me nr.1539/9 xerox, datë 11.05.2020, sipas të cilit data e zhvillimit të tenderit është 25.05.2020, ora 12⁰⁰ dhe afati i kryerjes së shërbimit është 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës;
- formulari i njoftimit të kontratës nr.1539/16 xerox, datë 19.06.2020, sipas të cilit data e lidhjes së kontratës është 19.06.2020;
- Formulari i kontratës nr.1539/15 xerox, datë 19.06.2020, ku sipas shtojcës 10 ‘Sasia dhe grafiku i lëvrimit’, bashkëlidhur, afati i kryerjes së shërbimit është 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës;
- Relacion shërbimi, pa datë, i mbajtur midis QSHA dhe subjektit ‘Kallfa’ sh.p.k., për dorëzimin e konsumablave të pajisjeve xerox D125, sipas të cilit për shërbimet e kryera janë mbajtur proces verbalet përkatëse në ditën e kryerjes së shërbimit. Procesverbalet e përshkruara në këtë relacion mbajnë këto data 23.06.2020; 12.10.2020; 03.11.2020; 04.02.2021; 23.02.2021; 13.04.2021; 28.04.2021; 02.05.2021; 24.05.2021 dhe 24.05.2021.
- Situacioni mbi kryerjen e shërbimeve, i mbajtur midis QSHA dhe subjektit ‘Kallfa’ sh.p.k., që mban datën 27.05.2021, në të cilin shprehen se deri në datë 24.05.2021, janë kryer realisht shërbimet e mirëmbajtjes dhe janë vendosur/ndërruar pjesët;
- Fatura tatimore nr.529, datë 21.03.2022, në shumën 895 320 lekë, për furnizimin e pjesëve dhe vendosjen/ndërrimin e tyre në printerët përkatës.

Sa më sipër, konstatohen mangësitë e më poshtme:

- Nuk rakordon kronologjia e veprimeve; kontrata (datë 19.06.2020), situacioni mbi kryerjen e shërbimeve 27.05.2021) dhe faturës së furnizimit (datë 21.03.2022), pasi rezulton se pjesët janë vendosur në vitin 2021, ndërsa fatura që tregon kohën kur janë furnizuar pjesët, është lëshuar në vitin 2022, çfarë tregon për dokumentim fiktive të procesit, sepse pjesët janë vendosur/ndërruar përpara se të furnizohen;
- Nuk ka një proces verbal për marrjen në dorëzim të pjesëve të furnizuara;
- Nuk ka kontroll lidhur me pranimin apo jo të dokumentacionit, që justifikon pagesën, në aspektin e përputhjes me kërkesat ligjore në fuqi, përpara se të kryhej pagesa.

Referuar sa më sipër, veprimet e kryera për pagesën kanë krijuar apo krijojnë problematika që lidhen me mosrespektimin e afateve dhe kushteve kontraktuale, kryerjen e pagesave të paargumentuara dhe justifikuara nga ana ligjore, keqpërdorimit të fondeve, mungesën e transparencës dhe dëmtimin e reputacionit të institucionit etj. Lëshimi i faturës një vit pas kryerjes së shërbimit ka krijuar paqartësi dhe vështirësi për justifikimin e shpenzimeve, pasi një vonesë e tillë ngre dyshime në lidhje me përputhshmërinë ligjore të procesit. Për të minimizuar këto rrisqe, është e rëndësishme që të verifikohen dhe sqarohen plotësisht të gjitha dokumentet dhe proceset që lidhen me pagesat dhe kontratat, përpara se të kryhen pagesat, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me legjislacionin dhe kërkesat kontraktuale.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me përcaktimet në nenin 12/3/e, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me kushtet e kontratës që lidhen me dorëzimin, verifikimin dhe pranimin e mallrave e shërbimeve, të furnizuara.

Titulli i gjetjes: Në kryerjen e pagesës për “Riparim pajisje printimi buklete”, nuk janë zbatuar procedurat ligjore dhe afatet e përcaktuara në kontratë, pasi kontrata është lidhur në qershor 2020, situacioni mbi kryerjen e shërbimeve është bërë në maj 2021, ndërsa fatura është lëshuar në mars

2022, duke krijuar dyshime për një dokumentim fiktiv të procesit dhe pasiguri në lidhje me ligjshmërinë e shpenzimeve.

Nr. i Gjetjes 8	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Kontrata nr.1539/15 xerox, datë 19.06.2020.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në kryerjen e pagesës për “Riparim pajisje printimi buklete”, nuk janë zbatuar procedurat ligjore dhe afatet e përcaktuara në kontratë, pasi kontrata është lidhur në qershor 2020, situacioni mbi kryerjen e shërbimeve është bërë në maj 2021, ndërsa fatura është lëshuar në mars 2022, duke krijuar dyshime për një dokumentim fiktiv të procesit dhe pasiguri në lidhje me ligjshmërinë e shpenzimeve. Kriteri: Kryerja e pagesave, nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të përcaktuara në nenin 12/3/e, të tij dhe me kushtet e kontratës që lidhen më dorëzimin, verifikimin dhe pranimin e mallrave e shërbimeve, të furnizuara. Ndikimi/Efekti: Është se mangësitë e konstatuara krijojnë dyshime për një dokumentim fiktiv të procesit, duke krijuar pasiguri në lidhje me ligjshmërinë e shpenzimeve, për shkak të mosrespektimit të kërkesave ligjore dhe procedurave të parashikuara apo mungesë transparence dhe besimi në proceset e pagesave. Shkak: Mos zbatim i kërkesave ligjore dhe rregullave të përcaktuara për dokumentimin dhe justifikimin e pagesave.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Në kryerjen e pagesës për “Riparim pajisje printimi buklete”, rezultojnë se ka mangësi të konsiderueshme në dokumentimin dhe justifikimin e pagesës, të cilat ndikojnë në besueshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij procesi. Mungesa e dokumenteve të nevojshme, të cilat duhet të pasqyrojnë saktë të dhënat që lidhen më dorëzimin, verifikimin dhe pranimin e mallrave e shërbimeve, të furnizuara, krijon mundësi për keqpërdorim dhe shkelje të procedurave të parashikuara. Po ashtu, vonesat në realizimin e pagesave, pavarësisht fondeve të mjaftueshme, reflektojnë mangësi në menaxhimin dhe transparencën e procesit. Këto mangësi kërkojnë masa të menjëhershme për të siguruar dokumentimin dhe procedurat e nevojshme, për të garantuar korrektësinë, transparencën dhe ligjshmërinë e pagesave në të ardhmen.
Rekomandimi	- QSHA, të analizojë rastin, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi. - QSHA, të marrë masa për vendosjen e sistemeve të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shmangin çdo mundësi për keqpërdorim të fondeve apo krijojnë pasiguri ligjore, si dhe sigurojnë transparencën e procesit e llogaridhënien për çdo veprim të kryer.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Sa më sipër, auditimi shpreh se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë nuk kanë vepruar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

b. Gjithashtu u konstatuan raste të përdorimit të fondeve për udhëtim e dieta brenda vendit, pa faturë tatimorë të fiskalizuar për biletat e udhëtimit/faturë hoteli dhe dieta për distanca më pak se 50 kilometra, që në këtë rast trajtimi financiar përfshin vetëm shpenzimet e transportit, si në rastin e U. Shpenzimeve nr.47, datë 07.03.2024, nr.48, datë 07.03.2024, nr.49, datë 07.03.2024 dhe nr.59, datë 19.03.2024, për titullarin dhe punonjësit e QSHA, jo në përputhje me përcaktimet në kreun III, pikat/1/2, pika 3/b dhe kreun IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit, për titullarin dhe punonjësit e saj, pa faturë tatimorë të fiskalizuar për biletat e udhëtimit/faturë hoteli dhe dieta për distanca më pak se 50 kilometra, jo në përputhje me përcaktimet në VKM -në nr.997, datë 10.12.2010, i ndryshuar.

Nr. i Gjetjes 9	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit, të cilat i ka trajtuar në mënyrë të gabuar, pasi biletat e udhëtimit dhe faturat e hotelit ishin të pa fiskalizuara. Gjithashtu, janë trajtuar shpenzime për udhëtime me distanca më të shkurtër se 50 kilometra, që nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.997, datë 10.12.2010, i ndryshuar. Kriteri: Kryerja e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit, është jo në përputhje me përcaktimet në kreun III pikat/1/2, pika 3/b dhe kreu IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore me ndikim financiar negativ për shumën e pagesave të kryera, jo në përputhje me përcaktimet në VKM -në nr.997, datë 10.12.2010, i ndryshuar dhe që i korrespondojnë sipas rastit titullarit apo punonjësve të dërguar me shërbim. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mos respektimi i procedurave ligjore lidhur me përlllogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve për udhëtim e dieta, për titullarin apo punonjësit e QSHA, kanë ndikim financiar negativ për buxhetin e institucionit, duke krijuar mungesë transparence dhe menaxhimin jo efikas të fondeve publike. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve të identifikuar, eliminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	- QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë qendrës së punës, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentojë me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë referuar përcaktimeve të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar. - QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit titullarit apo punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përlllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

c. Në pagesat për udhëtim e dieta jashtë vendit, të kryera me U. Shpenzimet nr.454, nr.455 dhe nr.456, datë 23.01.2024, rezulton se me urdhër të titullarit të QSHA nr.156, datë 07.11.2023, janë caktuar të shkojnë më shërim në qendrën ENIC-NARIC Francë, për vizitë studimore, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave për njësimin e diplomave. Kjo është në kuadër të zbatimit të marrëveshjes grantit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023, e cila kishte si objekt financimin e pagesave për shpenzimet që duhen përballuar për zbatimin e projektit, ku u konstatuan mangësitë si vijon:

- Ishin kryer pagesa, për shpenzime udhëtimi të pa justifikuara me dokumentacion justifikues si fatura/bileta;
- Vlera e dietës në valutë që është paguar, rezulton më e madhe se vlera që duhej të paguhej, sipas përcaktimeve ligjore.

Pagesat e mësipërme janë përlllogaritur dhe paguar, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e grantit të lidhur ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023, si dhe jo në përputhje me VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".

Titulli i gjetjes: QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit, pa dokumentacionin e duhur që justifikon shpenzimet dhe për vlera më të mëdha se kufijtë e lejueshëm të dietës/ditore.

Nr. i Gjetjes 10	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Marrëveshja e lidhur ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023; VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".
Përshkrimi i gjetjes	Situata: QSHA, ka kryer shpenzime për udhëtime dhe dieta jashtë vendit, të cilat nuk janë të justifikuara me dokumentacionin ligjor të nevojshëm, si fatura ose bileta dhe që vërtetojnë ligjshmërinë e shpenzimeve. Gjithashtu, vlera e dietës që është paguar në valutë rezulton të jetë më e madhe se sa vlera që duhej paguar, sipas dispozitave ligjore dhe rregulloreve të përcaktuara për këtë qëllim. Kriteri: Kryerja e shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, është jo në përputhje me përcaktimet në marrëveshjen e grantit të lidhur ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023, si dhe jo në përputhje me VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit". Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore me ndikim financiar negativ për shumën e pagesave të kryera, pa dokumentacionin e duhur justifikues dhe për dietat e paguara mbi vlerën ligjore. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mos respektimi i procedurave ligjore lidhur me përlllogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve për udhëtim e dieta, kanë ndikim financiar negativ për buxhetin e institucionit, krijon mungesë transparence dhe menaxhim jo efikas të fondeve publike. Mungesa e dokumentacionit të nevojshëm dhe pagesat më të larta se ato të



	miratuara mund të çojnë në përgjegjësi ligjore, humbje besimi dhe ndëshkime financiare. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve të identifikuar, është e domosdoshme, në mënyrë që të respektohen rregullat dhe procedurat ligjore për të shmangur ndikimet negative dhe për të siguruar menaxhim të drejtë dhe të përgjegjshëm të shpenzimeve.
Rekomandimi	- QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë vendit, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentoj me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë referuar përcaktimeve të VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. - QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përlllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të paguara më tepër, të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

d. Me urdhër shpenzimet nr.428, datë 20.01.2025, ishin kryer pagesa për transport dokumentacioni të maturës shtetërore, për llogari të subjektit “Ulysses Enterprises” sh.p.k., në shumën 90 000 lekë. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit konstatohet:

- Urdhër prokurimi nr.159, datë 09.10.2024, është nxjerrë pa përlllogaritur më parë fondin dhe nuk përmban të dhënat për fondin, llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti), emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave, veprim jo në përputhje me përcaktimet në nenin 77 “Urdhri i prokurimit” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Urdhri i prokurimit, i referohet një baze ligjore të shfuqizuar rreth 3 vite më parë;
- Urdhër prokurimi ka për objekt transportin e dokumentacionit (Teste, kuti) për maturën shtetërore 2024, por që nuk ka të përcaktuar destinacionin e lëvizjes (nisje, mbërritje dhe kthim), ndërkohë që provimet e kësaj maturë kanë përfunduar në periudhat Qershor, për sezonin e I dhe në fund të muajt Gusht-fillim Shtatori, për sezonin e II, për rrjedhojë kemi mospërputhje të kronologjisë së kryerjes së veprimeve, duke krijuar dyshime për veprime dhe pagesa fiktive;
- Procesverbal i prokurimeve me vlerë nën 100 000 lekë, datë 09.10.2024, me nr.1806/9 prot., të po kësaj date, i cili nuk përmban të dhënat bazë për këtë shërbim si destinacionet e lëvizjes testeve/kutive (kudo merren dhe ku do dërgohen) etj;
- Nuk ka asnjë dokument që vërteton realizimin e këtij shërbimi transporti;
- Fatura e furnitorit është lëshuar me nr.8110206, datë 31.12.2024, rreth 2.5 muaj, më vonë se urdhër prokurimi dhe nuk përputhet me periudhat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore.

e. Me urdhër shpenzimet nr.462, datë 22.01.2024, ishin kryer pagesa për shërbim transporti, për llogari të subjektit “Gentian Kacmoli”, në shumën 103 000 lekë. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit konstatohet:

- Urdhër prokurimi nr.191, datë 27.12.2023, është nxjerr pa përlogaritur më parë fondin dhe nuk përmban të dhënat për fondin, llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti), emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave, veprim jo në përputhje me përcaktimet në nenin 77 “Urdhri i prokurimit” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Urdhri i prokurimit, i referohet një baze ligjore të shfuqizuar rreth 3 vite më parë;
- Urdhër prokurimi ka për objekt shërbim transporti, por që nuk ka të përcaktuar llojin e transportit, destinacionin e lëvizjes (nisje, mbërritje dhe kthim), duke krijuar dyshime për veprime dhe pagesa fiktive;
- Procesverbal i prokurimeve me vlerë nën 100 000 lekë, datë 27.12.2023, me nr.5463/1 prot., të po kësaj date, i cili nuk përmban të dhënat bazë për këtë shërbim si çfarë do të transportohet dhe në çfarë destinacionesh do lëvizet etj;
- Nuk ka asnjë dokument që vërteton realizimin e këtij shërbimi transporti;
- Fatura e furnitorit është lëshuar me nr.204, datë 28.12.2023.

Gjithashtu përdorimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nën 100 000 lekë, nuk është i justifikuar ligjërisht, pasi kryerja e shërbimit të transportit është një proces i parashikueshëm dhe nuk është nevojë emergjente.

Sa më sipër, për të dy urdhrat e shpenzimeve, veprimet janë jo transparente dhe kanë mangësi të theksuara në dokumentacionin e prokurimit dhe realizimin e shërbimeve, duke përfshirë mungesën e informacionit të detajuar për procedurat e prokurimit, destinacionet e transportit, si dhe dokumentet që vërtetojnë realizimin e shërbimit. Këto mangësi krijojnë dyshime për veprime dhe pagesa fiktive dhe janë jo në përputhje me përcaktimet në nenin 12/3/e, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet në nenet 56, 76 dhe 77, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke kërkuar një shqyrtim të mëtejshëm të ligjshmërisë dhe transparencës në këto procese.

Titulli i gjetjes: QSHA, ka kryer shpenzime për transport, pa dokumentacionin e duhur që justifikon pagesat e bëra, duke krijuar dyshime për veprime dhe pagesa fiktive.

Nr. i Gjetjes 11	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: QSHA, ka kryer shpenzime për transport, të cilat nuk janë të justifikuara me dokumentacionin ligjor të nevojshëm, si për atë të procedurës së prokurimit dhe për dokumentet që vërtetojnë realizimin e shërbimit. Mungesa e dokumenteve krijon dyshime të veprimeve dhe pagesave fiktive dhe mbi ligjshmërinë dhe transparencën e procesit të prokurimit e të pagesave. Kriteri: Kryerja e shpenzimeve të transportit, është jo në përputhje me përcaktimet në nenin 12/3/e, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe me përcaktimet në nenet 56, 76 dhe 77, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

	Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore me efekt financiar negativ, pasi ishin kryer pagesa fiktive, duke keqpërdorur fondet publike dhe ka minuar transparencën dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit publik, si dhe të realizimit të shërbimit transportit. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Pagesat e kryera për transportin, pa dokumentacionin e nevojshëm ligjor, si për atë të procedurës së prokurimit dhe për dokumentet që vërtetojnë realizimin e shërbimit, krijojnë dyshime serioze për mundësinë e veprimeve dhe pagesave fiktive, duke shkelur dispozitat ligjore në fuqi. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve, është e domosdoshme, në mënyrë që të respektohen rregullat dhe procedurat ligjore për të shmangur ndikimet negative dhe për të siguruar menaxhim të drejtë dhe të përgjegjshëm të fondeve publike.
Rekomandimi	QSHA, të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, si dhe të vendosë sisteme të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, shmangin çdo mundësi për keqpërdorim të fondeve, rrisin transparencën e llogaridhënien për çdo veprim të kryer, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

7. *Auditim i sistemit të prokurimeve me fonde publike. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike, vlerësimi i hartimit të nevojave konkrete për investime, mallra e shërbime, argumentimi e përlllogaritja e fondit limit, zbatimi i procedurave nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës, marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve, inventarizimi e arkivimi i dosjes.*

Për periudhën objekt auditimi, QSHA, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ka hartuar, miratuar dhe dërguar në APP, regjistrat e parashikimeve për prokurimin publik, si dhe regjistrat e realizimit të prokurimeve publike.

Referuar regjistrave të realizimit të prokurimeve publike të QSHA, rezultoi se për periudhën objekt auditimi të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara ishin brenda kufirit monetar për prokurimet me vlerë të vogël, me përjashtim të procedurës me objekt "Blerje letër A3 & A4, për printimin e testeve të maturës shtetërore", zhvilluar në vitin 2022.

Për mallrat dhe shërbimet me vlerë nën 100 000 lekë, QSHA kishte bërë planifikimin e tyre dhe vlerat përkatëse i kishte pasqyruar respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto mallra e shërbime ishin bërë sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit me objekt: "Blerje materiale kancelarie e të tjera zyre", me objekt "Blerje shërbim marrje me qira kompjuterë", për vlerësimin ndërkombëtar "PISA Field Trial 2025", me objekt "Blerje shërbim transport kompjuterë", të

zhvilluar në vitin 2024, me objekt *“Blerje letër A3 & A4, për printimin e testeve të maturës shtetërore”*, zhvilluar në vitin 2022 dhe me objekt *“Blerje materiale konsumi për pajisje Xerox D125”* zhvilluar në vitin 2023.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit u konstatua mangësi e karakterit të përputhshmërisë ligjore, si më poshtë vijon:

a. QSHA, nuk ka ndjekur procedurat e parashikuara për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, pasi nuk ka dokumente që vërtetojnë këtë proces, ndërkohë që një nga detyrat kryesore të autoritetit kontraktues është të sigurojë një plan të qartë dhe të dokumentuar për nevojat e punëve, mallrave dhe shërbimeve. Mungesa e një plani të dokumentuar, krijon vështirësi në vendosjen e kontrolleve të duhura mbi përdorimin e fondeve publike dhe mund të çojë në keqpërdorime apo shpërdorime të fondeve dhe burimeve.

Veprimet janë jo në përputhje me kërkesat e VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nen 1 “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”, pika 2, ku citohet: *“Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”*, si dhe të nenit 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 1, ku citohet: *“Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera”*.

Sa më sipër, mungesa e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, ndikon negativisht në të gjitha aspektet e menaxhimit të fondeve publike, duke sjellë pasiguri financiare, keqmenaxhim të burimeve, dhe rritje të mundësive për shkelje të ligjit dhe keqpërdorimit të fondeve publike. Për të minimizuar këto ndikime, është e nevojshme që autoritetet të krijojnë dhe të mbajnë një sistem të fortë dhe transparent për planifikimin dhe dokumentimin e nevojave dhe shpenzimeve.

Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime.

Nr. i Gjetjes 12	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Mungesa e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime. Kriteri: Mos dokumentimi dhe mos administrimi i dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, është jo në përputhje me përcaktimet në nenin 1 “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”, pika 2, ku citohet: <i>“Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”</i> , si dhe me përcaktimet në nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 1, ku citohet: <i>“Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim,</i>

	autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Mos dokumentimi i procesit, krijon mundësi që vlera e fondit të prokuruar të mos jetë reale, duke përfshirë shpërdorim të mundshëm të fondeve publike, mungesë transparence dhe vështirësi në auditim. Kjo mund të çojë në përdorim të paefektshëm të burimeve, shkelje të ligjit për prokurimin dhe menaxhimin e fondeve, si dhe vonesa në realizimin e objektivave. Për më tepër, kjo dëmton besueshmërinë e institucionit dhe rrit rrezikun e keqpërdorimeve, duke shkaktuar pasiguri financiare dhe duke minuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Shkak: Menaxhimi i dobët i procesit të planifikimit, për arsye të mungesës së kontroleve dhe mos zbatimit të procedurave ligjore që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mungesa e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime ka potencialin të ndikojë negativisht në të gjitha aspektet e menaxhimit të fondeve publike, duke sjellë pasiguri financiare, keqmenaxhim të burimeve, dhe rritje të mundësive për shkelje të ligjit dhe keqpërdorimit të fondeve publike. Për të minimizuar këto ndikime, është e nevojshme që QSHA, të krijojë dhe të mbajë një sistem të fortë dhe transparent për planifikimin dhe dokumentimin e nevojave dhe shpenzimeve.
Rekomandimi	QSHA, të forcojë kapacitetet e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të krijojë dhe zbatojë procedura të qarta dhe të dokumentuara për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, duke siguruar që të mbahen dokumentet përkatëse që vërtetojnë këtë planifikim, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

b.Nuk ishte dokumentuar mënyra e përlllogaritjes së fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre, veprim jo në përputhje me përcaktimet në germën ç/pika 2, neni 2 “Dokumentimi i procesit” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet: “Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: vlerën dhe mënyrën e përlllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla”, si dhe me përcaktimet në pikën 4, paragrafi II, të nenit 56 ‘Procedura e prokurimit me vlerë të vogël’, ku citohet: “Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme”.

Sa më sipër, duhet të përgatitet një dokument i qartë dhe i detajuar që shpjegon mënyrën se si është përlogaritur fondi limit për secilin objekt prokurimi, i cili duhet të përfshijë analizën e çmimeve të tregut, kostot e mundshme dhe të tjerë faktorë që ndikojnë në përcaktimin e fondit limit. Ky dokument të nënshkruhet nga përgjegjësit dhe të jetë pjesë e dokumenteve të dosjes së çdo procedure prokurimi apo të arkivohet, sipas rregullave përkatëse në fuqi, për të mundësuar verifikimet nga grupet e kontrollit.

Titulli i gjetjes: Nuk ishte dokumentuar mënyra e përlogaritjes së fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve e punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre.

Nr. i Gjetjes 13	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nuk ishte dokumentuar mënyra e përlogaritjes së fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre. Kriteri: Mos dokumentimi i mënyrës së përlogaritjes së fondit limit, është jo në përputhje me përcaktimet në germën ç/pika 2, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, si dhe me përcaktimet në pikën 4, paragrafi II, të nenit 56 ‘Procedura e prokurimit me vlerë të vogël’, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Mos dokumentimi i procesit të përlogaritjes së fondit limit, krijojnë mundësi që vlera e përlogaritur e prokurimit të mos jetë reale. Shkaku: Mungesa e kontrolleve dhe mos zbatimi i procedurave ligjore që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Ndikimi ka qenë mos respektim i procedurave ligjore lidhur me përlogaritjen e fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve të identifikuara, eliminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	Për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, që do të prokurohen nga njësi publike, në çdo rast të bëhet dokumentimi i mënyrës së përlogaritjes së fondit limit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

c.Lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura, u konstatua se nuk u gjet asnjë urdhër për ngritjen e grupeve për monitorimin e zbatimit të kontratave, për rrjedhojë nuk ishin mbajtur as proces verbal, për marrjen në dorëzim të shërbimeve apo mallrave të furnizuara, lidhur me sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre, si dhe të dokumentacionit shoqërues, veprim jo në përputhje

me përcaktimet në pikën 3, të nenit 107 'Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës', të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet: "*Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi*".

Sa më sipër, se, për shkak të mungesës së urdhrit për ngritjen e grupeve të monitorimit dhe mos mbajtjes së procesverbaleve për marrjen në dorëzim të shërbimeve apo mallrave, nuk është realizuar mbikëqyrja e duhur e zbatimit të kontratave. Autoriteti kontraktues duhet të monitorojë dhe regjistrojë çdo aspekt të zbatimit të kontratave, për të siguruar përputhshmërinë e cilësisë së punëve, shërbimeve dhe mallrave me ato që janë shpallur në ofertën fituese. Mungesa e këtij procesi ka krijuar një mjedis të pasigurt në lidhje me realizimin e kontratave dhe mund të çojë në mosrespektimin e kushteve dhe standardeve të përcaktuara.

Titulli i gjetjes: Nuk ishin ngritur grupe pune për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura dhe për rrjedhojë nuk ishin mbajtur as proces verbalet, për marrjen në dorëzim të punëve, shërbimeve apo mallrave të furnizuara, lidhur me sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre, si dhe të dokumentacionit shoqërues.

Nr. i Gjetjes 14	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nuk ishin ngritur grupe pune për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhur dhe për rrjedhojë nuk ishin mbajtur as proces verbalet, për marrjen në dorëzim të punëve, shërbimeve apo mallrave të furnizuara, lidhur me sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre, si dhe të dokumentacionit shoqërues. Kriteri: mos përputhje me përcaktimet në: -pikën 3, të nenit 107 'Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës', të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet: "<i>Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi</i>"; Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore që lidhen me monitorimin e zbatimit të kontratës, e cila mund të sjell efekte negative, pasi zbatimi mund të mos bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokurua dhe me legjislacionin në fuqi. Shkaku: Mungesa e kontrolleve dhe procedurave që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë

Konkluzioni	Nuk janë respektuar procedurat ligjore lidhur me monitorimin dhe zbatimin e kontratave. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve, ndaj rrisqeve të identifikuara, eliminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	QSHA, në të gjitha rastet e prokurimit të fondeve publike, për kontratat e lidhura të ngrejë grupet për monitorimin e zbatimit të tyre, për t'u siguruar që të gjitha proceset e marrjes në dorëzim të punëve, shërbimeve dhe mallrave, të dokumentohen në mënyrë të rregullt dhe të mbahen procesverbalet përkatëse në praninë e kontraktorit, si dhe për të verifikuar përputhshmërinë e cilësisë, sasisë, llojit dhe plotësisë së punëve dhe furnizimeve, për të cilat është shpallur fitues kontraktori.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këtë rast nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

ç. Rezultoi se anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave nuk kishin nënshkruar një deklaratë përmes së cilës të deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, veprim jo në përputhje me përcaktimet në pikën 5, të nenit 13, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku citohet: *“Në çdo rast, duhet të shmangët rreptësishtë çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”*, si dhe me përcaktimet në pikën 2, të nenit 80 ‘Hapja e ofertave’, ku citohet: *“Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës”*.

Sa më sipër, rezulton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave kanë shkelur procedurat e përcaktuara nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, duke mos nënshkruar një deklaratë për të shpallur mungesën e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës. Ky veprim është jo në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik, që kërkojnë deklarimin e qartë të çdo konflikti të mundshëm interesi për të siguruar transparencë dhe integritet në procesin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e këtyre deklaratave mund të krijojë dyshime mbi objektivitetin dhe drejtësinë e procedurës së prokurimit.

Titulli i gjetjes: Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave nuk kishin nënshkruar një deklaratë përmes së cilës të deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Nr. i Gjetjes 15	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave nuk kishin nënshkruar një deklaratë përmes së cilës të deklarojnë se nuk

	ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteri: Veprimi është në mos përputhje me përcaktimet në pikën 2, të nenit 80 'Hapja e ofertave', të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Ndikimi/Efekti: mund të krijohet dyshimi për parregullsi ose favorizim të ofertuesve të caktuar, çka mund të dëmtojë transparencën dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit. Kjo mund të çojë në kontestime ligjore, vonesa në realizimin e procedurave të prokurimit dhe mundësi për korrupsion ose keqpërdorim të burimeve publike. Gjithashtu, mungesa e një procedure të qartë për shpërndarjen e mundshme të konflikteve të interesit mund të ndikojë negativisht në reputacionin e institucionit dhe në besimin e publikut ndaj procesit të prokurimit; Shkak: Mungesa e kontroleve dhe procedurave që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Mungesa e nënshkrimit të deklaratës për konflikt interesi nga anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave ka krijuar apo mund të krijojë rrisht të lartë në procesin e prokurimit. Ky veprim mund të dëmtojë transparencën, integritetin dhe besueshmërinë e procesit. Mungesa e këtij dokumentimi të rëndësishëm mund të çojë në kontestime ligjore, vonesa dhe ndikime negative në reputacionin e institucionit përkatës.
Rekomandimi	Anëtarët e komisioneve që përfshihen në procesin e vlerësimit të ofertave, përpara hapjes së ofertave, të nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, për të siguruar transparencën dhe integritetin e procesit, duke parandaluar çdo mundësi për favorizim të ofertuesve dhe për të shmangur dyshimet e mundshme.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimeve sa më sipër, sistemet e kontrollit në këto raste nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

8. Auditim i sistemit të kontabilitetit financiar. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, regjistrimi kronologjik i veprimeve kontabël, funksionimi e rakordimi i llogarive, ligjshmëria e dokumenteve justifikues për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara, hartimi i pasqyrave financiare dhe dorëzimi tyre.

Për periudhën objekt auditimi organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, si dhe mbyllja e llogarive vjetore, është bërë bazuar në VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr.248, datë 10.04.1998", si dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Pasqyrat financiare për viteve objekt auditimi, janë hartuar nga P/S/Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe janë miratuar nga Titullari i institucionit, si dhe ishin dërguar në Degën e Thesarit. Në aktivin e bilancit vlera e aktiveve të patrupëzuara, aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe

aktivet qarkulluese (gjendja e inventarit) janë të papërputhura me rezultatin e inventarizimit fizik, pasi nuk ishin kryer inventarizimet nuk ishin kryer në fund të viteve, për rrjedhojë edhe evidentimi në kontabilitet nuk është konform përcaktimeve ligjore.

Amortizimi i aktiveve nuk është llogaritur sipas normave të përcaktuara dhe dokumentacionit përkatës për çdo grup të veçantë, konform normave të amortizimit të parashikuara në nenin 22 “Amortizimi”, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe me normat e amortizimit të parashikuara në nenin 51 “Amortizimi”, të Ligjit nr.29, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pasi nuk ishin dokumentuar me çmime dhe vlera, kjo pasi nuk ka një regjistër për aktivet e institucionit. Detyrimet kreditore paraqiten në pasiv të bilancit, të cilat janë për marrëdhënie koherente dhe përbëhen nga pagat, sigurimet shoqërore, taksat, e shpenzime të tjera, që përbëjnë të detyrimet që QSHA ka ndaj shtetit, punonjësve etj., për muajin Dhjetor, të cilat janë shlyer në fillim vitit pasardhës.

Referuar konstatimeve sa më sipër, vlerësojmë se sistemet e kontrollit në këto raste, nuk kanë funksionuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore fuqi.

Nga verifikimi i dokumenteve, u konstatua se, në aktivin e bilanceve të viteve 2022 dhe 2023, vlera e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese (gjendja e inventarit) janë pasqyruar me vlerën e tyre kontabël, pa u krahasuar me gjendjen fizike të inventarizimit të tyre (nuk janë kryer inventarizimet), për rrjedhojë të dhënat për treguesit sasiore dhe ato të vlerës nuk janë të plota, të sakta e të besueshme. Në këto kushte vlera e pasqyruar në bilanc e llogarive të “Aktiveve afat gjata materiale” dhe llogarive të “Inventarit Qarkullues”, si dhe vlera e amortizimit të akumuluar apo vjetor, nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

Pasqyrimi i aktiveve në bilancet e viteve 2022 e 2023, me vlerën e tyre kontabël, pa u krahasuar me gjendjen fizike të inventarizimit, pa saktësuar vërtetësinë e këtyre llogarive nuk paraqet vlerën reale të tyre dhe është në mos përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kreu III, pika 30, ku citohet: *“Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”*.

Në aspektin e pasqyrave financiare, mangësitë dhe problematikat e identifikuara në procesin e inventarizimit të aktiveve kanë krijuar disa rrisqe që lidhen me:

- Pasaktësinë e pasqyrave financiare, pasi mungesa e të dhënave të sakta kontabël ka krijuar pasaktësi në regjistrimin e pasurive dhe ka bërë që pasqyrat financiare të reflektojnë vlera të pasakta, duke çuar në një pasqyrim të gabuar të pasurive dhe detyrimeve të institucionit;
- Mungesën e transparencës në vlerësimin e aktiveve, pasi mos vlerësimi i plotë dhe jo i rregullt i aktiveve, ka bërë që vlerat e aktiveve, të amortizimit apo vlera e mbetur e tyre, të jenë të pasakta, kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në pasqyrat financiare, për shkak të pasaktësive në llogaritë e amortizimit dhe llogaritë e aktiveve neto;
- Mungesën e kontrollit për diferencat apo dëmtimet e mundshme që rezultojnë gjatë inventarizimit dhe pa një raport të detajuar, është e vështirë të bëhen korrigjimet e nevojshme në pasqyrat financiare, çfarë ka cenuar besueshmërinë e tyre;
- Vështirësi në përcaktimin e përgjegjësisve për mangësitë dhe dëmtimet e aktiveve, nëse rezultojnë të tilla nga inventarizimi;
- Mos paraqitjen e saktë të pozicionit financiar të institucionit, pasi pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë gjendjen e vërtetë të pasurive dhe detyrimeve reale;
- Mungesën e dokumentacionit, për përputhshmërinë me standardet financiare dhe ligjore, që ka çuar në mosrespektimin e tyre.

Sa më sipër, mangësitë e identifikuar në procesin e inventarizimit të aktiveve kanë bërë që pasqyrat financiare të jenë jo të besueshme dhe jo në përputhshmëri me përcaktimet ligjore në fuqi, pasi nuk japin një pasqyrim të saktë të situatës financiare të QSHA.

Titulli i gjetjes: Mangësitë në procesin e inventarizimit të aktiveve kanë çuar në pasaktësi të pasqyrave financiare, mungesë transparence, vështirësi në përcaktimin e përgjegjësisve dhe mosrespektim të standardeve ligjore, duke bërë që ato të jenë të pasakta dhe të pa-besueshme.

Nr. i Gjetjes 16	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve ka krijuar mangësi të rëndësishme, që lidhen me të dhëna jo të sakta kontabël, pasaktësi në vlerësimin e aktiveve dhe amortizimit, si dhe mungesën e kontrollit për dëmet apo diferencat e mundshme gjatë inventarizimit. Këto probleme kanë bërë që pasqyrat financiare të jenë të pasakta, me mungesë transparence dhe janë në mos përputhje me kërkesat ligjore, duke cënuar besueshmërinë e tyre dhe duke bërë të pamundur paraqitjen e një pasqyrimi të saktë të situatës financiare të institucionit. Kriteri: Veprime këto jo në përputhje me përcaktimet në me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", kreu III, pika 30, ku citohet: "<i>Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet</i>". Ndikimi/Efekti: Ndikimi i këtyre mangësive është serioz, pasi ka çuar në pasqyra financiare të pasakta dhe të pa-besueshme, duke rrezikuar besimin e institucionit. Mungesa e transparencës dhe e kontrollit të duhur ka vështirësuar marrjen e vendimeve të informuara, ka krijuar pasiguri në lidhje me pozicionin financiar dhe ka shkaktuar shkelje të mundshme të standardeve ligjore dhe financiare. Kjo dëmton reputacionin e institucionit dhe ndikon negativisht në besueshmërinë e tij te partnerët dhe investitorët. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mangësitë në procesin e inventarizimit të aktiveve kanë krijuar një pasqyrë të pasaktë dhe të pa-besueshme të situatës financiare të

	institucionit, duke rrezikuar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe financiare. Për të përmirësuar besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe për të shmangur rrisqet e mëtejshme, është e nevojshme që të kryhet procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe kontrollit të aktiveve, si dhe një monitorim dhe dokumentim i saktë dhe i rregullt.
Rekomandimi	- Për hartimin e pasqyrave financiare të sakta dhe të besueshme, QSHA, të kryej inventarizim e plotë dhe të saktë të aktiveve, në mënyrë që të pasqyrojë gjendjen reale të tyre. - Hartimi, përgatitja, paraqitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore, të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kontabël, në mënyrë që të sigurohet kontabilizimi i plotë, i saktë dhe në kohë i të gjitha transaksioneve, me qëllim që të japin gjendjen reale të pozicionit financiar dhe transaksioneve, si dhe informacion transparent e të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit, vlerësojmë se sistemet e kontrollit lidhur me pasqyrimin e aktiveve në kontabilitet, si dhe në bilanci të viteve 2022 e 2023, me vlerën e tyre kontabël, pa u krahasuar më parë me gjendjen fizike të inventarizimit, pa saktësuar vërtetësinë e këtyre llogarive, nuk ka funksionuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore fuqi.

9. Auditimi i sistemit për menaxhimin e aktiveve. Hartimi i gjurmës së auditit, menaxhimi i aktiveve sipas përgjegjësi, marrja në dorëzim, inventarizimi fizik, si dhe vlerësimi e nxjerrja jashtë përdorimit.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për periudhën objekt auditimi nga QSHA, nuk ishin marrë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, pasi u konstatuan mangësi serioze në lidhje me menaxhimin e tyre, si dhe mos vlerësim i riskut të lidhur me to, për sa më poshtë vijon:

a. Nga titullari që ka menaxhuar njësinë publike, për periudhën objekt auditimi nuk ishin nxjerrë dhe miratuar rregulla specifike dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, referuar kërkesave të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, i cili (Titullari) është përgjegjës për miratimin e tyre, referuar përcaktimeve në pikën 5, të Udhëzimit, ku citohet: "Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi".

Titulli i gjetjes: Nuk ishin hartuar dhe miratuar rregulla specifike dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

Nr. i Gjetjes 17	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja bazë ligjore	Udhëzimi Nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Përshkrimi i gjetjes	Situata:Nuk është hartuar regjistri kontabël për të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim QSHA, referuar Kreut III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafët 26-72, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kriteri: Veprime këto jo në përputhje me paragrafët 26-72, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Mungesa e regjistrave krijon pasiguri dhe vështirësi në krijimin e raporteve financiare të sakta, ndikon negativisht në besueshmërinë e institucionit, në marrjen e vendimeve, si dhe krijon probleme ligjore dhe fiskale. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mos hartimi i regjistrat kontabël paraqet risk të lartë për institucionin, pasi shkakton pasiguri financiare, probleme ligjore e fiskale, dhe ndikim negativ në reputacion dhe menaxhim. Ky problem kërkon ndërhyrje urgjente për të siguruar pasqyrimin e saktë të transaksioneve financiare.
Rekomandimi	Të hartohet regjistri kontabël për të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim QSHA, si dhe të përditësohen në vazhdimësi të dhënat, me qëllim mirëmenaxhimin e aktiveve, referuar përcaktimeve të Kreut III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafët 26-72, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

c. Nga verifikimi i dokumentacionit të inventarizimit për vitet 2022, 2023 dhe 2024, rezulton se për vitin 2022 ishte nxjerrë urdhri nr.194, datë 17.11.2022, "Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve". Ky urdhër është shfuqizuar me urdhrin nr. 37, datë 20.04.2023, i cili përsëri kishte si qëllim ngritjen e komisioneve për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Pas këtij urdhri, për vitin 2023 ishte nxjerrë dhe urdhri nr.149, datë 25.10.2023, "Për ngritjen e një komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve". Për vitin 2024, nuk është nxjerrë një urdhër për inventarizimin e aktiveve, duke krijuar një boshllëk në procedurat e menaxhimit të inventarizimit dhe pasqyrimin të pasurive të organizatës. Për inventarizimin konstatohen mangësitë si vijon:

- Nuk janë nxjerrë rregullisht urdhrat për krijimin e komisioneve të inventarizimit;
- Nëpunësi zbatues nuk ka hartuar listën e aktiveve për inventarizim;
- Fletët e inventarit përmbajnë të dhëna vetëm për sasinë fizike, të rezultuar nga inventarizimi, pasi nuk ka të dhëna kontabël;
- komisionet e inventarizimit të aktiveve, në rastet e krijuara të sipërcituar, nuk kanë përmbushur përgjegjësitë ligjore, pasi nuk kanë dokumentuar plotësisht procesin lidhur me:
 - Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.

- Krahësimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.
- Përpilimin e një raporti lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues".

Sa më sipër, për vitet objekt auditimi, nuk janë nxjerrë urdhra rregullisht për krijimin e komisioneve të inventarizimit. Nuk është hartuar lista e aktiveve për inventarizim dhe fletët e inventarit përmbajnë vetëm të dhëna për sasinë fizike, pa të dhëna kontabël. Komisionet e inventarizimit nuk kanë dokumentuar procesin siç duhet, lidhur me verifikimin fizik të aktiveve, krahasimin me të dhënat kontabël dhe përpilimin e procesverbaleve dhe raporteve përkatëse. Kjo ka çuar në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe pasaktësi në pasqyrimin e aktiveve. Kjo situatë ka krijuar pasiguri financiare dhe administrative, vështirësi në menaxhimin e burimeve dhe është jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 9/4/ë dhe nenin 12/3/dh/ë/f, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në kreun IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Për këtë situatë kërkohet ndërhyrje urgjente për të siguruar që inventarizimi të realizohet sipas rregullave dhe kërkesave ligjore.

Titulli i gjetjes: Titullari i QSHA, nuk ka nxjerr rregullisht urdhrat për krijimin e komisioneve të inventarizimit. Nëpunësi zbatues nuk ka hartuar listën e plotë të aktiveve për inventarizim. Fletët e inventarit përmbajnë të dhëna vetëm për sasinë fizike, pa informacione kontabël, si dhe komisionet e inventarizimit nuk kanë dokumentuar procesin sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Nr. i Gjetjes 19	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Komisionet e ngritura, për inventarizimin nuk kanë dokumentuar procesin e inventarizimit të aktiveve, referuar përcaktimeve në pikën 85, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Kriteri: Këto veprime janë, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 9/4/ë dhe nenin 12/3/dh/ë/f, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në kreun IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Kjo situatë, ka krijuar vështirësi në menaxhimin e aktiveve, ka bërë që pasqyrimi i aktiveve të jetë i pasaktë dhe jo i përditësuar, si dhe ka krijuar pasaktësi në pasqyrat financiare dhe shkelje të procedurave ligjore. Ndikimi i plotë, mund të shihet vetëm pas përfundimit të procesit të inventarizimit, referuar rezultatit të tij.

	Shkaku Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I Lartë.
Konkluzioni	Procesi i inventarizimit të aktiveve ka patur mangësi të rëndësishme, pasi nuk janë nxjerrë rregullisht urdhra për krijimin e komisioneve të inventarizimit, nëpunësi zbatues nuk ka hartuar listën e aktiveve për inventarizim, fletët e inventarit përmbajnë të dhëna vetëm për sasinë fizike të aktiveve dhe mungojnë të dhënat kontabël, që janë të nevojshme për të bërë krahasimin dhe nxjerr diferencat nëse ka. Komisionet e inventarizimit nuk kanë dokumentuar plotësisht procesin e verifikimit dhe krahasimit të aktiveve, sipas kërkesave ligjore në fuqi duke krijuar pasiguri në menaxhimin e pasurive dhe që ndikojnë në saktësinë dhe transparencën e pasqyrave financiare.
Rekomandimi	- QSHA, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos kryerjen e inventarizimeve të aktiveve, si dhe të marrë masa të menjëhershme për të verifikuar ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës, nëpërmjet zbatimit të procedurave të inventarizimit. - Nëpunësi zbatues të hartojë listën e plotë të aktiveve për inventarizim, e cila të përditësohet rregullisht dhe të përfshijë të dhëna të plota dhe të sakta për çdo aktiv. - Komisionet e inventarizimit duhet përdorin fletë inventari që përmbajnë të dhëna kontabël, në mënyrë që të kenë mundësin e krahasimit me të dhënat nga verifikimi fizik për secilin aktiv, si dhe të dokumentojnë plotësisht procesin e inventarizimit, referuar përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

d. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për periudhën objekt auditimi ishin kryer veprime me arkë, për transaksionet financiare për blerje materiale apo kryerje shërbimesh, me vlera të vogla dhe me magazinën për lëvizjen e aktiveve, por konstatohet se:

- nuk ishte caktuar një punonjës për të kryer veprimet e arkëtimit dhe të pagesës me para në dorë, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës;
- nuk ishte caktuar një punonjës për të mbajtur dhe kryer veprimet me magazinën;
- dalja nga magazina bëhej pa plan shpërndarje apo miratim nga titullari;
- nuk ishte kryer verifikimi i gjendjes së arkës asnjëherë.

Sa më sipër, QSHA në organikë nuk ka të miratuar pozicion pune për arkëtar dhe as për magazinier. Titullari i QSHA, nuk ka caktuar punonjësit përkatës për kryerjen e veprimeve të arkës dhe të magazinës. Gjithashtu, lëvizja e materialeve nga magazina ishte bërë pa një plan shpërndarjeje apo miratim nga titullari, si dhe nuk ishte bërë verifikimi i gjendjes së arkës, duke krijuar mundësi për keqpërdorim ose gabime në menaxhimin e burimeve financiare dhe materiale. Mos vendosja e kontrolleve për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit kundrejt keqpërdorimit apo përdorimit të paautorizuar, ka sjellë që dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë, si dhe dokumentimi i lëvizjes së aktiveve.

të bëhet jo në përputhje me përcaktimet në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në referencë të përcaktimeve të pikës 15, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nuk mund të ngarkohet edhe me detyrën e arkëtarit dhe/ose magazinierit menaxheri që urdhëron për hyrjen dhe daljen e aktiveve, si dhe nëpunësi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë. *Në institucione, ku nuk justifikohet ekzistenca e një pozicioni të veçantë pune për arkëtarin dhe magazinierin, ky pozicion mund të vendoset në çdo pozicion tjetër pune.*

Referuar paragrafit 38, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

Po ashtu, sipas paragrafit 80, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, verifikimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.

Titulli i gjetjes: Mungesa e kontrollit dhe procedurave të qarta për caktimin e punonjësve për kryerjen e veprimeve me arkë dhe magazinë.

Nr. i Gjetjes. 20	
Subjekti i Audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Gjatë periudhës së auditimit, janë kryer veprime me arkë për transaksione financiare si blerje materiale apo shërbimesh, si dhe për lëvizjen e aktiveve nga magazina, por janë konstatuar disa mangësi në organizimin dhe kontrollin e këtyre veprimeve, pasi nuk ishte caktuar një punonjës për kryerjen e veprimeve të arkës dhe as për mbajtjen dhe menaxhimin e magazinës. Lëvizjet e materialeve nga magazina janë bërë pa një plan shpërndarjeje apo pa miratim nga titullari, dhe nuk ishte kryer verifikimi i gjendjes së arkës. Këto mangësi rrisin rrezikun për gabime ose për keqmenaxhimin e fondeve dhe aktiveve. Kriteri: veprimet nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Është se mungesa e kontrollit të duhur dhe caktimit të përgjegjësive për veprimet e arkëtimit, pagesave dhe lëvizjeve të magazinës krijon mundësi: që të ndodhin gabime në regjistrimin e transaksioneve dhe lëvizjeve të materialeve, për keqmenaxhim me fondet dhe burimet materiale, duke e vështirësuar mundësinë për të verifikuar gjendjen e arkës dhe të aktiveve. Kjo gjithashtu rrit rrezikun e përdorimit të pasigurt të fondeve dhe burimeve, si dhe mund të shkaktojë pasiguri në

	raportimin financiar, duke ndikuar në besueshmërinë e procesit financiar dhe të menaxhimit të aktiveve. Shkaku: Mungesa e kontrolleve dhe zbatimit të procedurave që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mungesa e caktimit të punonjësve për menaxhimin e arkës dhe magazinës, si dhe procedurat e pamjaftueshme për miratimin dhe verifikimin e lëvizjeve, kanë krijuar mundësi për gabime dhe pasiguri në menaxhimin e fondeve dhe materialeve. Për të përmirësuar sistemin e kontrollit dhe për të siguruar një menaxhim efikas dhe të sigurt, është e nevojshme të caktohen punonjës të autorizuar për këto procese, të krijohet një procedurë e qartë për miratimin e lëvizjeve të materialeve dhe të kryhet verifikimi i rregullt i gjendjes së arkës dhe aktiveve.
Rekomandimi	-Drejtori i QSHA, me urdhër të veçantë të ngarkojë një punonjës të institucionit, për kryerjen e veprimeve me arkë dhe një punonjës tjetër për kryerjen e veprimeve me magazinën, në zbatim të paragrafit 15, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. -QSHA, të krijojë dhe miratojë një procedurë të detajuar për lëvizjen e materialeve nga magazina, duke përfshirë një plan shpërndarjeje të miratuar nga titullari, për të parandaluar gabimet. -Nëpunësi zbatues të bëjë verifikimin e rregullt të gjendjes së arkës dhe materialeve në magazinë, për të garantuar saktësinë e regjistrimeve dhe për të identifikuar çdo mospërputhje ose gabim në kohë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, auditit shprehet se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

10. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit.

➤ Rregullorja e brendshme për funksionimin e QSHA, protokolluar me nr.1462 prot., datë 02.09.2014, është e miratuar para më shumë se 10 vjet dhe nuk i përgjigjet më kërkesave dhe ndryshimeve të kohës, për një funksionim të efektshëm të sistemeve të kontrollit. Kjo rregullore nuk është përditësuar për të adresuar zhvillimet e reja dhe nevojat e ndryshuara, duke rrezikuar efikasitetin dhe sigurinë e proceseve operative dhe të menaxhimit të QSHA.

Sa më sipër, rregullorja aktuale ka çuar apo mund të çojë në keq menaxhimin e sistemeve të kontrollit dhe të operacioneve të përditshme. Kjo mund të rrisë mundësinë për gabime, mosrespektim të kërkesave ligjore, duke ndikuar negativisht në sigurinë dhe integritetin e proceseve të brendshme të QSHA. Mungesa e përditësimeve mund të shkaktojë vonesa në përshtatjen me ndryshimet teknologjike dhe rregulloret e reja, duke rritur riskun operacional dhe ligjor.

Titulli i gjetjes: Rregullorja e brendshme, është e vitit 2014 dhe e pa azhurnuar me zhvillimet e reja, për funksionimin normal të QSHA.

Nr. i Gjetjes 21

Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 8 pika 8/ë, e tij;
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Rregullorja e brendshme për funksionimin e QSHA, është miratuar para më shumë se 10 vjet më parë dhe nuk është përditësuar për t'iu përgjigjur ndryshimeve të kohës dhe kërkesave të reja. Kjo ka sjellë mangësi në përshtatjen e sistemeve të kontrollit dhe proceseve operative, duke rrezikuar efikasitetin dhe sigurinë e menaxhimit të QSHA. Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 8 pika 8/ë, e tij; Ndikimi/Efekti: Rregullorja është e vitit 2014 dhe e paazhurnuar krijon pasiguri dhe mundësi për mangësi në menaxhimin dhe kontrollin e proceseve të brendshme të QSHA. Ajo mund të çojë në mungesë efikasiteti, vështirësi në përshtatjen me ndryshimet e teknologjisë dhe kërkesave ligjore, si dhe mund të rrisë rrezikun e gabimeve në menaxhimin e sistemeve të kontrollit dhe operacioneve të përditshme. Shkaku: Mos vëmendje e duhur lidhur me nevojën për rishikimin dhe përditësimin e rregullores në përputhje me zhvillimet e reja teknologjike dhe ligjore, si dhe kërkesat në rritje për menaxhim efikas dhe të sigurt të sistemeve të kontrollit dhe operacioneve të QSHA. Mungesa e një procesi të rregullt për rishikimin dhe azhurnimin e politikave dhe rregulloreve ka bërë që ajo të mbetet pa përditësuar dhe e papërshtatshme për nevojat e institucionit.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Rregullorja e brendshme e QSHA, e miratuar mbi 10 vjet më parë, nuk i përgjigjet më kërkesave të kohës dhe nuk mbulon nevojat aktuale për një menaxhim efikas dhe të sigurt të sistemeve të kontrollit. Kjo ka shkaktuar mangësi në përshtatjen me zhvillimet e reja dhe ndikon negativisht në efikasitetin dhe sigurinë e operacioneve të QSHA. Azhurnimi i rregullores është thelbësor për përmirësimin e kontrollit dhe sigurisë në menaxhimin e proceseve të brendshme.
Rekomandimi	QSHA të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për rishikimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e QSHA", që ajo të mbulojë nevojat e ndryshuara për menaxhimin e sistemeve të kontrollit dhe proceseve operative, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar të institucionit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, audit i shprehet se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi.



➤ Qendra e Shërbimeve Arsimore, me urdhrin nr.102, datë 03.06.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për operatorët (Data Entry) të provimeve kombëtare të maturës shtetërore 2024, sesioni i parë”, ka ngritur një grup pune prej 5 vetash. Nga verifikimi i dokumenteve rezultoi se QSHA, ka lidhur kontratat e punës me nr.2464/1 dhe nr.2464/2, datë 03.06.2024, vetëm me 2 nga punonjësit e përfshirë në urdhër, me afat katër javor, ndërsa për 3 punonjësit e tjerë, nuk rezulton të jenë lidhur dhe nënshkruar kontrata përkatëse. Për të 5 punonjësit e marrë sipas urdhrit, pagesat ishin bërë me U. Shpenzimet nr.197, nr.198, datë 24.07.2024 dhe me nr.232, datë 27.08.2024. Mos lidhja e kontratave të punës me punonjësit e marrë në punë, është jo në përputhje me kërkesat e nenit 12 “Kontrata e punës” të Ligjit nr.7961, date 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, te ndryshuar, ku citohet: **“Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim”**. Lidhja e kontratave të punës është një proces i domosdoshëm për të siguruar transparencën dhe përputhshmërinë me normat ligjore në fuqi.

Sa më sipër, mungesa e kontratave dhe kryerja e pagesave pa kontratë ka krijuar apo mund të krijojë problematika që lidhen me:

- Shkelje të kërkesave të Ligjit nr.7961, date 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, te ndryshuar, rregullores së brendshme të QSHA, si dhe procedurave që lidhen me pagesën;
- Mundësi për kontestime ligjore nga ana e punonjësve të jashtëm, të cilët mund të kërkojnë kompensime të ndryshme ligjore, si për sigurime shoqërore e shëndetësore, pushime të papaguara apo përfitime të tjera që nuk janë realizuar, në varësi të rrethanave dhe të përcaktimeve të ligjit të punës në fuqi.
- Përfitime të paautorizuara nga individët, duke krijuar mundësinë për keqpërdorime të mundshme ose ndarje të padrejtë të burimeve financiare dhe duke e bërë procesin të paqartë e të pasigurt nga pikëpamja ligjore dhe financiare.

Sugjerime për përmirësim:

- Qendra e Shërbimeve Arsimore, duhet të sigurohet që për çdo angazhim të punonjësve të jashtëm të nënshkruhen kontrata të rregullta të punës, përpara se ata të fillojnë të kryejnë shërbimet dhe të realizohen pagesat për ta, pasi kjo do të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve dhe do të sigurojë përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi.
- Vendosija e kontrolleve më të forta mbi procedurat e pagesave, për tu siguruar që pagesat të kryhen vetëm pasi të jenë lidhur kontratat përkatëse dhe të jetë e qartë natyra e shërbimeve të ofruara.
- Hartimi i udhëzimeve, në mënyrë që të respektohen të gjitha procedurat dhe rregulloret e përcaktuara, si dhe organizimi i trajnimeve të nevojshme të stafit.

Titulli i gjetjes: Qendra e Shërbimeve Arsimore, ka angazhuar punonjës të jashtëm, si dhe ka kryer pagesa për shërbimet e ofruara prej tyre, pa lidhur kontratë pune për 3 nga punonjësit.

Nr. i Gjetjes 22	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit nr.7961, date 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, te ndryshuar; Udhëzimi i ministrit të arsimit dhe sportit nr.8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”;

Njohjes së Lisbonës – mbështetje për Qendrat ENIC. Për projektin ishte lidhur marrëveshja grantit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me nr.1121/2, datë 20.03.2023, e cila kishte si objekt financimin e pagesave për shpenzimet që duhen përballuar për zbatimin e projektit, për një shumë maksimumi 49 725 euro. Në vijim të marrëveshjes QSHA ka lidhur kontrata me konsulent për kryerjen e disa shërbimeve të specifikuara, të cilat kanë si objektiv rritjen e aftësiye të QSHA për njohjen e kualifikimeve si p.sh.kontrata nr.1121/28 prot., datë 22.11.2023, nr.5293/1 prot., datë 18.12.2023, nr.4773/2 prot., datë 12.12.2023 etj. Referuar kushteve të cilësuara në këto kontrata, konkretisht në nenet 7 dhe 9 të tyre përcaktohet:

Neni 7;

Konsulenti merr për sipër të respektojë të gjitha rregullat e zbatueshme dhe të respektojë detyrimet e tij/saj fiskale në:

- Dërgimin e një fature në QSHA, në përputhje me legjislacionin e vendit të tij/saj të vendbanimit fiskal;
- Duke deklaruar të gjitha tarifat e marra nga QSHA, për qëllime tatimore siç kërkohet në vendin e tij/saj të vendbanimit fiskal.

Neni 9;

- Në këmbim të përmbushjes nga konsulenti të detyrimeve sipas kontratës, këshilli merr për sipër të paguajë konsulentin, për përmbushjen e detyrave të renditura në nenin 1, të kontratës;
- 6 ditë punë (norma për njësi 300 euro);
- Konsulenti do të jetë në Shqipëri, për 4 ditë pune, ku shpenzimet e udhëtimit dhe dieta ditore, dreka, darka, akomodimi transferta (175 euro për njësi), do të mbulohen nga granti;
- Tarifa është përfundimtare dhe nuk i nënshtrohet rishikimit. Shuma do të paguhet Brenda 60 ditëve kalendarike, pas marrjes së produkteve dhe pranimi të saj QSHA dhe me paraqitjen e një fature.

Pas verifikimit të dokumenteve dhe procesit të pagesave, janë identifikuar disa mangësi dhe shkelje të kushteve të përcaktuara në kontrata, si më poshtë vijon:

- mos dorëzim i produktit dhe pranimin e tij nga QSHA, pasi nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë dorëzimin nga konsulentët, të produkteve të kërkuara dhe pranimin e tyre nga QSHA. Ky fakt tregon mos funksionim të sistemit, në menaxhimin dhe verifikimin e produktit të dorëzuar, çfarë rrezikon cilësinë e punës dhe efikasitetin e projektit;
- mos paraqitjen e faturës nga konsulentët për shërbimin e kryer prej tyre, veprim ky në shkelje të procedurave financiare dhe tregon një rrezik të mundshëm për të krijuar situata të paqartë për menaxhimin e fondeve;
- mos dokumentim i përllogaritjes së shumave të pagesave sipas rastit për secilin konsulent, duke krijuar mundësi për keqmenaxhim të fondeve të projektit dhe ndërlikim të procesit të auditimit;
- mos mbajtjen e tatimit në burim për pagesat e bëra, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe duke krijuar efekt negative për buxhetin.

Problematikat dhe mungesat e identifikuara, kanë krijuar apo mund të krijojnë rrisht lidhur me:

- keqpërdorimin e fondeve, duke krijuar raste për humbje të mundshme të parave nga buxheti i projektit, për shkak të mos dokumentimit të saktë dhe kontrollit të pamjaftueshëm;
- mosrespektimin e kërkesave ligjore, për përllogaritjen dhe mbajtjen e tatimeve, veprime që çojnë në raportime të pasakta, duke krijuar mundësi për sanksione ligjore për institucionin apo punonjësit;
- humbjen e besimit të palëve të interesuara, pasi kjo situatë mund të krijojë pasiguri tek partnerët dhe donatorët, si dhe të dëmtojë reputacionin e QSHA-së, duke shkaktuar pasoja afatgjata.

Sugjerime për përmirësime nga QSHA:

- QSHA, duhet të sigurojë procedura të qarta, në mënyrë që çdo produkt të dorëzohet dhe të miratohet zyrtarisht me një akt pranimi, në të cilin të evidentohen mosdorëzimet, i cili duhet të ruhet si dokument zyrtar dhe si pjesë e arkivës së dokumenteve të projektit;

- Të kërkojë detyrimisht paraqitjen e faturave nga konsulentët pas përfundimit të shërbimit, si dhe të sigurohet që çdo faturë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale, nëpërmjet vendosjes së një sistemi monitorimi dhe kontrolli për verifikimin e faturave të paraqitura për shërbimet e kryera, duke ndihmuar në ruajtjen e transparencës dhe qëndrueshmërisë financiare;
- Të dokumentojë përlllogaritjen e shumave për çdo pagesë të kryer për secilin konsulent, duke siguruar që çdo pagesë të bazohet në një përlllogaritje të qartë dhe të arsyeshme të shërbimit të ofruar, nëpërmjet vendosjes së një sistemi kontrolli, që të verifikojë që çdo pagesë të bëhet në përputhje me kontratën dhe shërbimin e kryer;
- Të respektohen procedurat, duke dokumentuar qartë procedurën për përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim, për të gjithë konsulentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të forcohen procedurat e kontrollit të brendshëm për të siguruar që të gjitha proceset financiare dhe administrative të ndjekin rregullat dhe procedurat e përcaktuara. Po ashtu, të organizohen trajnime të rregullta për stafin e QSHA-së dhe konsulentët mbi menaxhimin e fondeve, procedurat e faturimit dhe mbajtjen e tatimeve, për të rritur ndërgjegjësimin dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe kontraktuale;
- Të krijohet një sistem monitorimi dhe raportimi për të siguruar që çdo aktivitet dhe pagesë të monitorohet dhe të raportohen rregullisht, duke përfshirë një kontroll të rreptë mbi proceset e pagesave dhe tatimeve, kjo do të ndihmojë në identifikimin e çdo mospërputhjeje dhe përmirësimin e menaxhimit të fondeve.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumenteve dhe i procesit të pagesave për kontratat e lidhura me konsulentët, janë identifikuar mangësi të rëndësishme, që përfshijnë: mungesën e dokumenteve që vërtetojnë dorëzimin dhe pranimin e produkteve nga konsulentët, duke treguar mosfunksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit dhe verifikimit të produkteve, mos paraqitjen e faturave nga konsulentët për shërbimet e kryera, duke krijuar paqartësi dhe rrezik për menaxhimin e fondeve, mungesën e dokumentimit të përlllogaritjeve të shumave të pagesave për secilin konsulent, që mund të çojë në keqpërdorim të fondeve dhe komplikime gjatë auditimit dhe mos mbajtjen e tatimit në burim për pagesat e bëra, duke e shkelur legjislacionin fiskal dhe duke rrezikuar buxhetin e projektit. Këto mangësi krijojnë rrezeqe për keqpërdorimin e fondeve të projektit, mosrespektimin e kërkesave ligjore, dhe humbjen e besimit nga palët e interesuara, duke çuar në mundësinë e sanksioneve ligjore dhe dëmtimit të reputacionit të QSHA-së. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me kushtet e përcaktuara në kontratat e lidhura, të sipërpërmendura.

Titulli i Gjetjes: Mungesa e dokumentacionit dhe mosrespektimi i procedurave ligjore dhe financiare, në menaxhimin e kontratave dhe pagesave të kryera për konsulentët, i cili rrezikon integritetin e projektit dhe mundësitë e auditimit.

Nr. i Gjetjes 23	
Subjekti i audituar	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	QSHA; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Kontratat: nr.1121/28 prot., datë 22.11.2023, nr.5293/1 prot., datë 18.12.2023, nr.4773/2 prot., datë 12.12.2023 etj.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në pagesat e kryera, për konsulentët është konstatuar mungesë e dokumentacionit dhe mosrespektimi i procedurave ligjore dhe financiare, në menaxhimin e kontratave, në lidhje me mosdorëzimin e pranimin e produkteve, mosparaqitjen e faturës nga



	konsulentët për shërbimin e kryer prej tyre, mos dokumentimin e përlllogaritjes së shumave të pagesave sipas rastit për secilin konsulent dhe mos mbajtjen e tatimit në burim për pagesat e bëra. Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e përcaktuara në nenet 7 dhe 9, të kontratave: nr.1121/28 prot., datë 22.11.2023, nr.5293/1 prot., datë 18.12.2023, nr.4773/2 prot., datë 12.12.2023 etj. Efekti: Shkelje e procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën. Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontrolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Në verifikimin e dokumenteve dhe procesit të pagesave për kontratat e lidhura me konsulentët, janë identifikuar mangësi të rëndësishme, përfshirë mungesën e dokumenteve të pranimit të produkteve, mos paraqitjen e faturave për shërbimet e kryera, mungesën e përlllogaritjes së saktë të shumave të pagesave dhe mos mbajtjen e tatimit në burim për pagesat. Këto mangësi krijojnë rreziqe për keqpërdorimin e fondeve të projektit, mosrespektimin e kërkesave ligjore, dhe humbjen e besimit nga palët e interesuara, duke çuar në mundësinë e sanksioneve ligjore dhe dëmtimit të reputacionit të QSHA-së.
Rekomandimi	- Të krijohet dhe implementohet një procedurë e qartë për dorëzimin dhe pranimin e produkteve, e cila të sigurojë që çdo produkt regjistrohet në dokumente dhe miratohet zyrtarisht nga QSHA dhe konsulentët, si dhe ruhet në mënyrë të detajuar si pjesë e arkivës së projektit. - Në përmbushje të kushteve të kontratës, QSHA të kërkojë detyrimisht paraqitjen e faturave nga konsulentët pas përfundimit të shërbimit, si dhe të sigurohet që çdo faturë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale, përpara se të realizohen pagesat, nëpërmjet vendosjes së një sistemi monitorimi dhe kontrolli për verifikimin e faturave të paraqitura, në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me shërbimet e kryera, duke ndihmuar në ruajtjen e transparencës dhe përputhshmërinë me marrëveshjet. - Të dokumentojë përlllogaritjen e shumave për çdo pagesë që bëhet, duke siguruar që çdo pagesë të bazohet në një përlllogaritje të qartë, transparente dhe e cila të përfshijë kriteret dhe arsyetimin për llogaritjen, në mënyrë që vendosë një sistemi kontrolli, që të verifikojë se çdo pagesë të bëhet në përputhje me kontratën dhe shërbimin e kryer, si dhe parandalon keqpërdorimin e fondeve. - Të zbatohen detyrimisht procedurat ligjore në fuqi, duke dokumentuar qartë përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim, për çdo pagesë të bërë për konsulentët, me qëllim për të shmangur pasaktësitë dhe ndëshkimet ligjore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Opinion i përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në përfundim të angazhimit të auditimit grupi i punës shpreh opinionin e përgjithshëm për subjektin e audituar se: Sistemi i Kontrollit të Brendshëm sipas sistem/fushave të audituara nuk ka funksionuar në mënyrë efektive, pasi janë konstatuar mangësi serioze të cilat ekspozojnë institucionin ndaj rrisqeve të larta dhe veprime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim në objektivat e njësisë publike dhe për rrjedhojë ka nevojë për marrjen e veprimeve të rëndësishme, për përmirësime thelbësore në disa drejtime, referuar mangësive të trajtuara në raport.

Aneksi 1

Përmbledhëse e Rekomandimeve

Nr.	Rekomandimet	Niveli i riskut
1	<i>Nr.1:</i> QSHA, të kryejë procedurat për plotësimin e strukturës organike, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi. <i>Nr.1.1:</i> Deri në plotësimin e vendeve vakante të punës QSHA, të rishikojë shpërndarjen e detyrave dhe ngarkesën e punonjësve aktualë, në mënyrë që të siguroj realizimin e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj.	I lartë
2	Njësia e burimeve njerëzore në QSHA, tu kërkojë punonjësve që të paraqesin dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit dhe të bëjë, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar, referuar përcaktimeve të VKM-së nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".	I ulët
3	<i>Nr.3:</i> QSHA, përlllogaritjen e pagave ta bëjë sipas strukturës, vlerave të pagave, elementeve përbërës dhe kategorive përkatëse, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për pagat. <i>Nr.3.1:</i> QSHA, për periudhën e paguar më tepër dhe znj. të bëjë përlllogaritjet e pagës që lidhen me shtesën e vjetërsisë në pune, referuar përcaktimeve ligjore përkatëse për pagat, si dhe për diferencat të bëhen ndalcat përkatëse.	I lartë
4	<i>Nr.4:</i> QSHA, për mos aplikimin e tatimit mbi pagesat, sipas përcaktimeve në aktet përkatëse ligjore në fuqi, të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësinë, të bëjë përlllogaritjet për tatimin mbi të ardhurat, për periudhën e audituar, për çdo rast e punonjës, si dhe për diferencat e konstatuara të pa mbajtura të bëhen ndalesat përkatëse dhe të xhirohen në buxhetin e shtetit. <i>Nr.4.1:</i> QSHA, të xhirojë menjëherë në buxhetin e shtetit shumën prej 622,465 lekë, që përfaqëson tatimin mbi të ardhurat për honorarët dhe komisionet, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e përcaktuara. <i>Nr.4.2:</i> QSHA, të verifikojë dokumentacionin dhe të bëjë pagesën e shpërblimit për , në përputhje me urdhrin e SP.	I lartë
5	QSHA, të krijojë një sistem të plotë dhe transparent dokumentimi për orët e punuara dhe numrin e testeve të vlerësuara, me tarifa të qarta dhe të miratuara dhe listëpagesat të përmbajnë informacion të plotë për treguesit që lidhen me pagesat, si dhe të kenë nënshkrimet e menaxherëve përkatës. Gjithashtu, të implementohet një sistem monitorimi, i cili garanton kryerjen pagesave në kohë, për të siguruar ligjshmërinë dhe transparencën e procesit.	I lartë
6	<i>Nr.6:</i> QSHA, të marrë masa për krijimin e procedurave, që përcaktojnë qartë mënyrën e dokumentimit dhe trajtimit të orëve mbi kohën normale të punës, për të siguruar që çdo orë pune e kryer jashtë kohës normale të punës, të jetë e	I lartë



	dokumentuar, e justifikuar dhe të ketë mundësinë e kompensimit me pushime, përpara se të kërkohet miratimi i pagesës për këto orë, në mënyrë që të eliminohen shpenzimet e paautorizuara apo të paqarta dhe që janë jo në përputhje me rregullat përkatëse ligjore në fuqi. <i>Nr.6.1:</i> Titullari i QSHA-së, të përdorë çdo mundësi për kompensimin e orëve mbi kohën normale të punës, <i>me orë/ditë pushimi</i>, dhe për rastet kur nuk është e mundur dhënia e pushimit, duhet të argumentohen, justifikohen dhe dokumentohen arsyet e kryerjes së pagesave, duke u siguruar që veprimet janë në përputhje me përcaktimet në VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. <i>Nr.6.2:</i> QSHA, për çdo orë të realizuar mbi kohën normale të punës përfshirë ato të titullarit dhe për të cilat ka përdorur të gjitha mundësitë për kompensimin e tyre, <i>me orë/ditë pushimi</i>, të kërkojë paraprakisht miratimin e pagesës së tyre nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mënyrë që të rrisë transparencën, kontrollin dhe përputhshmërinë me ligjin, duke parandaluar keqpërdorimet dhe shkeljet në të ardhmen. <i>Nr.6.3:</i> QSHA, planifikimin dhe shpërndarjen e orëve mbi kohën normale të punës, që realizohen në kuadër të organizimit të provimeve të maturës shtetërore, ta bëjë në përputhje me faktorë të tillë si përvoja, aftësitë dhe numri i personave që nevojiten për secilën detyrë, rolin dhe angazhimin e secilit individ në proces, bazuar në një plan të qartë dhe të miratuar paraprakisht nga titullari dhe struktura përgjegjëse, me qëllim shmangien e favorizimeve dhe do të sigurojë trajtim të drejtë për të gjithë stafin.	
7	Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në QSHA, në vijim urdhrit të titullarit të institucionit “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit”, me qëllim menaxhimit efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, me qëllim përcjelljen për në MAS të një informacioni sa më të plotë dhe të saktë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit.	I lartë
8	<i>Nr.8:</i> QSHA, të analizojë rastin, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi. <i>Nr.8.1:</i> QSHA, të marrë masa për vendosjen e sistemeve të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shmangin çdo mundësi për keqpërdorim me fondet apo krijojnë pasiguri ligjore, si dhe sigurojnë transparencën e procesit e llogaridhënien për çdo veprim të kryer.	I lartë
9	<i>Nr.9:</i> QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë qendrës së punës, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentoj me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë referuar përcaktimeve të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar. <i>Nr.9.1:</i> QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit titullarit apo punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.	I lartë
10	<i>Nr.10:</i> QSHA, në çdo rast të dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë vendit, trajtimin financiar të tyre, ta dokumentojë me dokumentacion të plotë dhe ta bëjë	I lartë

	referuar përcaktimeve të VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit". <i>Nr.10.1:</i> QSHA, për pagesat e bëra më tepër që i korrespondojnë sipas rastit punonjësve të dërguar me shërbim, të bëjë përllogaritjet për çdo rast e punonjës, për periudhën e audituar dhe për diferencat e konstatuara të paguara më tepër, të nxirret urdhri për arkëtim, si dhe të bëhen ndalesat përkatëse.	
11	QSHA, të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të përfshirë në proces, duke marrë masat korrigjuese dhe disiplinore, si dhe të vendosë sisteme të kontrollit, që sigurojnë përdorimin e fondeve dhe kryerjen e pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, shmangin çdo mundësi për keqpërdorim të fondeve, rrisin transparencën e llogaridhënien për çdo veprim të kryer, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.	I lartë
12	QSHA, të forcoj kapacitetet e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të krijojë dhe zbatojë procedura të qarta dhe të dokumentuara për planifikimin e nevojave për punë, mallra dhe shërbime, duke siguruar që të mbahen dokumentet përkatëse që vërtetojnë këtë planifikim, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.	I lartë
13	Për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, që do të prokurohen nga njësia publike, në çdo rast të bëhet dokumentimi i mënyrës së përllogaritjes së fondit limit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.	I mesëm
14	QSHA, në të gjitha rastet e prokurimit të fondeve publike, për kontratat e lidhura të ngrejë grupet për monitorimin e zbatimit të tyre, për t'u siguruar që të gjitha proceset e marrjes në dorëzim të punëve, shërbimeve dhe mallrave, të dokumentohen në mënyrë të rregullt dhe të mbahen procesverbalet përkatëse në praninë e kontraktorit, si dhe për të verifikuar përputhshmërinë e cilësisë, sasisë, llojit dhe plotësisë së punëve dhe furnizimeve, për të cilat është shpallur fitues kontraktori.	I lartë
15	Anëtarët e komisioneve që përfshihen në procesin e vlerësimit të ofertave, përpara hapjes së ofertave, të nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, për të siguruar transparencën dhe integritetin e procesit, duke parandaluar çdo mundësi për favorizim të ofertuesve dhe për të shmangur dyshimet për procedurën.	I lartë
16	<i>Nr.16:</i> Për hartimin e pasqyrave financiare të sakta dhe të besueshme, QSHA, të kryej inventarizim e plotë dhe të saktë të aktiveve, në mënyrë që të pasqyrojë gjendjen reale të tyre. <i>Nr.16.1:</i> Hartimi, përgatitja, paraqitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore, të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kontabël, në mënyrë që të sigurohet kontabilizimi i plotë, i saktë dhe në kohë i të gjitha transaksioneve, me qëllim që të japin gjendjen reale të pozicionit financiar dhe transaksioneve, si dhe informacion transparent e të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë.	I lartë
17	Titullari i QSHA, në mënyrë që të sigurojë menaxhim efikas të aktiveve dhe të parandalojë keqmenaxhimet e mundshme, të miratojë rregulla specifike dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.	I lartë
18	Të hartohet regjistri kontabël për të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim QSHA, si dhe të përditësohen në vazhdimësi të dhënat, me qëllim mirë menaxhimin e aktiveve, referuar përcaktimeve të Kreut III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", paragrafët 26-72, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.	I lartë

19	<i>Nr.19:</i> QSHA, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos kryerjen e inventarizimeve të aktiveve, si dhe të marrë masa të menjëhershme për të verifikuar ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës, nëpërmjet zbatimit të procedurave të inventarizimit. <i>Nr.19.1:</i> Nëpunësi zbatues të hartojë listën e plotë të aktiveve për inventarizim, e cila të përditësohet rregullisht dhe të përfshijë të dhëna të plota dhe të sakta për çdo aktiv. <i>Nr.19.2:</i> Komisionet e inventarizimit duhet përdorin fletë inventari që përmbajnë të dhëna kontabël, në mënyrë që të kenë mundësin e krahasimit me të dhënat nga verifikimi fizik për secilin aktiv, si dhe të dokumentojnë plotësisht procesin e inventarizimit, referuar përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.	I lartë
20	<i>Nr.20:</i> Drejtori i QSHA, me urdhër të veçantë të ngarkojë një punonjës të institucionit, për kryerjen e veprimeve me arkë dhe një punonjës tjetër për kryerjen e veprimeve me magazinën, në zbatim të paragrafit 15, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. <i>Nr.20.1:</i> QSHA, të krijojë dhe miratojë një procedurë të detajuar për lëvizjen e materialeve nga magazina, duke përfshirë një plan shpërndarjeje të miratuar nga titullari, për të parandaluar gabimet. <i>Nr.20.2:</i> Nëpunësi zbatues të bëjë verifikimin e rregullt të gjendjes së arkës dhe materialeve në magazinë, për të garantuar saktësinë e regjistrimeve dhe për të identifikuar çdo mospërputhje ose gabim në kohë.	I lartë
21	QSHA të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për rishikimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e QSHA", që ajo të mbulojë nevojat e ndryshuara për menaxhimin e sistemeve të kontrollit dhe proceseve operative, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar të institucionit.	I lartë
22	<i>Nr.22:</i> QSHA, në çdo rast të angazhimit të punonjësve të jashtëm të bëjë lidhjen e kontratave të rregullta të punës, në përputhje me ligjin e punës dhe procedurat administrative të institucionit, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen ligjore të të dy palëve dhe do të shmangë rrisqet e mundshme. <i>Nr.22.1:</i> QSHA, pagesat ti kryejë vetëm pasi të jenë lidhur kontratat përkatëse për punonjësit e jashtëm, për të siguruar që çdo pagesë të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe do të parandalojë mundësinë e keqpërdorimit të fondeve. <i>Nr.22.2:</i> QSHA, të marrë masa për krijimin dhe vendosjen e një sistemi të qartë kontrolli për pagesat e punonjësve të jashtëm, që përfshin lidhjen e kontratave dhe dokumentimin e plotë të shërbimeve të ofruara prej tyre.	I lartë
23	<i>Nr.23:</i> Të krijohet dhe implementohet një procedurë e qartë për dorëzimin dhe pranimin e produkteve, e cila të sigurojë që çdo produkt regjistrohet në dokumente dhe miratohet zyrtarisht nga QSHA dhe konsulentët, si dhe ruhet në mënyrë të detajuar si pjesë e arkivës të projektit. <i>Nr.23.1:</i> Në përmbushje të kushteve të kontratës, QSHA të kërkojë detyrimisht paraqitjen e faturave nga konsulentët pas përfundimit të shërbimit, si dhe të sigurohet që çdo faturë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale, përpara se të realizohen pagesat, nëpërmjet vendosjes së një sistemi monitorimi dhe kontrolli për verifikimin e faturave të paraqitura, në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me shërbimet e kryera, duke ndihmuar në ruajtjen e transparencës dhe përputhshmërinë me marrëveshjet. <i>Nr.23.2:</i> Të dokumentojë përlllogaritjen e shumave për çdo pagesë që bëhet, duke siguruar që çdo pagesë të bazohet në një përlllogaritje të qartë, transparente dhe e	I lartë



	cila të përfshijë kriteret dhe arsyetimin për llogaritjen, në mënyrë që vendosë një sistemi kontrolli, që të verifikojë se çdo pagesë të bëhet në përputhje me kontratën dhe shërbimin e kryer, si dhe parandalon keqpërdorimet me fondet. Nr.23.3: Të zbatohen detyrimisht procedurat ligjore në fuqi, duke dokumentuar qartë për llogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim, për çdo pagesë të bërë për konsulentët, me qëllim për të shmangur pasaktësitë dhe ndëshkimet ligjore	
24	QSHA, të analizojë situatën në tërësi, të identifikojë përgjegjësitë për çdo mangësi të konstatuar dhe të ndërmarrë masa urgjente për të adresuar shkeljet në përputhshmërinë ligjore dhe procedurat financiare. Kjo përfshin përmirësimin e menaxhimit të burimeve, dokumentacionit dhe kontrollit të pagesave, si dhe forcimin e monitorimit dhe transparencës në proceset e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Gjithashtu, është e domosdoshme përditësimi i rregulloreve të brendshme për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe efikas, që plotëson plotësisht kërkesat ligjore dhe financiare.	

GRUPI I AUDITIMIT

Isa Neza



Ilirjana Çina



Reagim nga subjekti i audituar

Subjekti i audituar:	Qendra e Shërbimeve Arsimore
Angazhimi i auditimit:	Nr.406/1prot., datë 22.01.2025
Data e raportimit:	më 19.03.2025

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë, në secilën nga fushat e përmendura.

Shkalla e vlerësimit

(1) – Shumë të kënaqur (2) – Të kënaqur (3) – Të pakënaqur (4) – Shumë të pakënaqur

Nr.	Komponentët e përfomancës (Sa të kënaqur jeni)	1	2	3	4	Komente
I	Planifikimi i Auditimit					
1	Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushe veprimin e auditimit para se të fillonte ?					
2	Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit ?					
II	Kryerja e auditimit					
3	Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes së auditimit ?					
4	Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë suaj ?					
5	A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit të auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan ?					
III	Raportimi i rezultateve të auditimit					
6	Projekt raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?					
7	Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur ?					
8	Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?					

9	Rekomandimet afruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuara ?					
10	Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme ?					
IV	Cilësia e auditimit të brendshëm					
11	Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes ?					
12	Auditimi ju afroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë ?					
13	A kontribuon auditimi i brendshëm në përmirësimin dhe arritjen e objektivave strategjike të organizatës Tuaj ?					
V	Shërbime të tjera të ofruara nga auditimi i brendshëm					
14	A jeni të vetëdijshëm se njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi ?					
15	Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë ?					

Ps: Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin “Komente” në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.

Drejtuesi i Institucionit
